

REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

STRATEGJIA
PËR FORCIMIN E KAPACITETEVE PËR KRYERJEN E HETIMEVE FINANCIARE
DHE KONFISKIMIN E PASURISË
PËR PERIUDHËN 2025-2028

ME PLAN VEPRIMI
2025-2026

PËRMBAJTJA:

Lista e shkurtesave	3
Përcaktimi konceptual i termave të përdorur	4
1.1.PËRBLËDHJE EKZEKUTIVE.....	6
1.2. Baza e obligimit për përgatitjen dhe propozimin e strategjisë.....	7
1.3. Ndërlidhja me strategji të tjera në fushë dhe fusha të ngjashme.....	7
1.4. Qasja metodologjike në përgatitjen e strategjisë	8
1.5. Procesi i përfshirjes së palëve të interesuara në përgatitje	9
2. ANALIZË E GJENDJES	10
2.1. Rezultatet nga zbatimi i strategjisë së mëparshme.....	11
2.2. Analizë e gjendjes aktuale në fushë	12
Pasqyrë e përgjithshme	12
Pasqyrë e gjendjes në fusha të veçanta	12
2.3. Tabelë për analizën SWOT dhe PESTLE	26
3. KORNIZA STRATEGJIKE	27
3.1. Vizioni, fushat prioritare, qëllimet e përgjithshme	24
3.3. Masa për realizimin e qëllimeve të veçanta	25
a). Fusha prioritare 1	28
b). Fusha prioritare 2	32
b). Fusha prioritare 3	34
4. KORNIZË PËR NDJEKJE, VLERËSIM DHE NJOFTIM	37
4.1. Pasqyrë tabelare e treguesve të suksesit në nivel të rezultatit, arritjes dhe efektit	37
4.2. Organet kompetente të angazhuara për zbatimin, ndjekjen, vlerësimin dhe njoftimin	37
4.3. Mënyra e grumbullimit të të dhënave	37
4.4. Mekanizëm për koordinim	37
4.5. Procedura dhe dinamika për njoftim dhe vlerësim të rezultateve të arritura	39
5. MENAXHIMI I RREZIQEVE	39
5.1. Rreziqet e identifikuara që mund të ndikojnë në zbatimin e qëllimeve të përgjithshme dhe të veçanta	39
5.2. Masat për ballafaqimin me rreziqet	39
5.3. Mënyra e rishikimit të planit të veprimit	39
6. PLANI FINANCIAR INDIKATIV	40

SHKURTESAT E PËRDORURA:

RMV	REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT
MPB	MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME
DPF	DREJTORIA E POLICISË FINANCIARE
DD	DREJTORIA DOGANORE
PP	PROKURORIA PUBLIKE
PTHPNKOK	PROKURORIA THEMELORE PUBLIKE PËR NDJEKJEN E KRIMIT TË ORGANIZUAR DHE KORRUPSIONIT
AGJPP	AKADEMIA E GJYKATËSVE DHE PROKURORËVE PUBLIK
DAP	DREJTORIA E TË ARDHURAVE PUBLIKE
DZF	DREJTORIA E ZBULIMIT FINANCIAR
MTD	MINISTRIA E TRANSFORMIMIT DIGJITAL
ASH	AVOKATURA SHETËTËRORE
BE	BASHKIMI EVROPIAN
AAPS	AGJENCIA E MENAXHIMIT ME PASURINË E SEKUESTRUAR
KP	KODI PENAL
LPP	LIGJI I PROCEDURËS PENALE
PSO	PROCEDURA STANDARDE OPERATIVE

**PËRKUFIZIMI KONCEPTUAL I
TERMAVE TË PËRDORUR:**

(1) Pasuri	Para ose mjete të tjera për pagesë, letra me vlerë, depozita, pasuri të tjera në çfarëdo forme, qofshin materiale ose jomateriale, përfshirë edhe mjetet virtuale në përputhje me ligjin, pasuri e luajtshme ose e paluajtshme, të drejta të tjera mbi sendet, kërkesa, si dhe akte publike dhe dokumente juridike për pronësinë dhe asetet në formë të shkruar ose elektronike, apo instrumente që përbëjnë dëshmi për të drejta pronësore ose interesa juridike
(2) Masa të përkohshme sigurim	Masa që përfshijnë ndalimin e përkohshëm të përdorimit, tjetërsimit, ruajtjes së përkohshme dhe sigurimin e pasurisë, ndalimin e ekzekutimit të transaksionit të caktuar që lidhet me para, depozitë, mjete virtuale për shkëmbim, aksione, pjesëmarrje, kontribute themeluese, letra me vlerë ose pasuri tjetër, bazuar në vendim gjyqësor.
(3) Konfiskim	Sekuestrim i përhershëm i pasurisë, përfitim pasuror i drejtpërdrejtë ose indirekt, që përfshin para, sende të luajtshme ose të paluajtshme me vlerë, si dhe çdo pronë tjetër, pasuri ose asete, të drejta materiale ose jomateriale dhe çdo pasuri që korrespondon me vlerën e përfitimit pasuror të fituar.
(4) Informacione financiare	Informacione që lidhen me pasurinë, paratë, shpenzimet dhe financat, të cilat potencialisht mund të jenë të dobishme për hetimin.
(5) Metoda e vlerës neto	Metodë me të cilën indirekt dëshmohet pasuria e fituar në mënyrë të paligjshme në rastet kur mjetet me të cilat disponon person i caktuar, përkatësisht shpenzimet e tij, tejkalojnë të ardhurat e ligjshme të deklaruar. Aplikohet gjatë hetimeve financiare të veprave penale kataloguese për qëllime të konfiskimit të zgjeruar.
(6) Përfitim nga vepra penale	Pasuri ose përfitim i fituar në mënyrë të drejtpërdrejt ose indirekt nga kryerja e veprës penale, përfshirë edhe të ardhurat nga vepra penale e kryer jashtë vendit, me kusht që në kohën e kryerjes veprimi të ishte parashikuar si vepër penale dhe sipas ligjeve të Republikës së Maqedonisë së Veriut.
(7) Pasuri e fituar në mënyrë të paligjshme	Përvetësim i kundërligjshëm i pasurisë, përfitimit pasuror dhe të ardhurave të tjera nga vepra penale, përkatësisht pasuria dhe përfitimet pasurore të fituara nga kryerja e veprës penale dhe të cilat vërtetohen në procedurë penale.
(8) Pasuri për të cilën nuk mund të dëshmohet se është nga burime ligjore	Pasuri për të cilën, në procedurën e rregulluar me ligj për konfiskimin e pasurisë në procedurë civile, nuk mund të dëshmohet se është fituar nga të ardhura të ligjshme dhe në mënyrë të ligjshme (nga burime të ligjshme).

HYRJE:

1.1. PËRMBLEDHJE E FUSHËS DHE DREJTIMET KRYESORE TË VEPRIMIT

Strategjia për forcimin e kapaciteteve për kryerjen e hetimeve financiare dhe konfiskimin e pasurisë për periudhën 2025-2028 (në tekstin e mëtejshëm: Strategjia 2025-2028) i përcakton prioritetet dhe qëllimet që duhet të arrihen gjatë katër viteve të ardhshme. Masat e propozuara për realizimin e tyre do të kontribuojnë që shteti ynë të vendoset mbi bazë më të fortë në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, përmes zbulimit efektiv dhe në kohë, konfiskimit dhe menaxhimit të pasurisë së fituar në mënyrë të paligjshme. E orientuar drejt ndërtimit të përgjigjes institucionale të fortë për përballimin e krimit dhe korrupsionit dhe arritjen e rezultateve konkrete dhe të dukshme, kjo strategji bazohet në bindjen se vetëm përmes konfiskimit të suksesshëm të pasurisë së fituar në mënyrë të paligjshme mund të krijojmë ambient ku “krimi nuk është fitimprurës”.

Baza e zbatimit të Strategjisë 2025-2028 janë institucionet efikase, transparente dhe llogaridhënese, ku koordinimi dhe bashkëpunimi ndërinstitucional është kusht i rëndësishëm për funksionalitetin e tyre. Për këto arsye, forcimi i kapaciteteve të institucioneve dhe promovimi i bashkëpunimit ndërinstitucional kanë qenë në fokus gjatë hartimit të masave në secilën nga fushat prioritare. Për më tepër, standardet universale të formuluar në konventat ndërkombëtare dhe të drejtën e BE-së që lidhen me konfiskimin e pasurisë së fituar në mënyrë të paligjshme, si dhe standardet që shteti ynë duhet të përmbushë për anëtarësim në BE, janë inkorporuar në masat që duhet të merren nga institucionet përkatëse gjatë kësaj periudhe 4-vjeçare.

Korniza ligjore, e cila është pjesë përbërëse e çdo fushe prioritare, duhet ta afrojë legjislacionin nacional me të drejtën e BE-së. Megjithatë, ligjet janë aq të mira sa është i mirë zbatimi i tyre. Për këto arsye, vetëm kuadro profesionistë të trajnuar, të cilët janë forca kryesore lëvizëse e procesit, mund t'i zbatojnë zgjidhjet ligjore dhe të sigurojnë rezultate konkrete. Për këtë qëllim, forcimi i kriterëve për përzgjedhjen e kuadrit dhe sigurimi i trajnimeve të vazhdueshme dhe të specializuara, të krijuara në përputhje me nevojat e institucioneve, janë imperativ në secilën nga fushat prioritare të kësaj strategjie.

Masat e përgjithshme të projektuara në këtë strategji synojnë të sigurojnë që konfiskimi i pasurisë dhe përfitimit pasuror të fituar në mënyrë të paligjshme të jetë prioritet strategjik në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit të nivelit të lartë, si dhe që sistemi i vendosur të mundësojë identifikimin dhe konfiskimin në kohë të fitimeve kriminale.

Konfiskimi i pasurisë dhe përfitimit pasuror të fituar në mënyrë të paligjshme është proces kompleks dhe shumëdimensional, i përbërë nga disa faza të veçanta, por të ndërlidhura ndërmjet tyre, në të cilat përfshihen disa institucione. Duke ndjekur fazat e procedurës për kthimin e pasurisë, Strategjia (2025–2028) i elaboron fushat e mëposhtme prioritare: (1) Gjetja, identifikimi dhe ndjekja e pasurisë dhe përfitimit pasuror të fituar në mënyrë të paligjshme brenda vendit dhe jashtë tij; (2) Sigurimi i përkohshëm dhe konfiskimi i pasurisë dhe përfitimit pasuror; dhe (3) Menaxhimi efektiv i pasurisë së sekuestruar dhe të konfiskuar, përfshirë edhe ripërdorimin e saj për qëllime sociale.

Strategjia 2025 - 2028 forcon strukturën institucionale për koordinimin dhe monitorimin e realizimit të qëllimeve të përcaktuara në këtë strategji. Në këtë drejtim, përveç Komisionit Nacional për Hetime Financiare dhe Konfiskimin e Pasurisë, i cili është trupi më i lartë ekspert, parashihet edhe hallkë shtesë që do të paraqesë nivelin më të lartë në strukturën e koordinimit: Këshilli Nacional për Hetime Financiare dhe Konfiskimin e Pasurisë.

Përgatitja e Strategjisë 2025 - 2028 u mbështet nga GIZ Shkup, në kuadër të Programit Global për Luftën e Flukseve Financiare të Paligjshme.

1.2. BAZA E DETYRIMIT PËR PËRGATITJEN DHE PROPOZIMIN E STRATEGJISË

Strategjia 2025-2028 ndërtohet mbi strategjitë e mëparshme të miratuara në këtë fushë¹. Vizioni i përbashkët i strategjive të deritanishme të miratuara është ndërtimi i përgjigjes institucionale efikase të shtetit tonë për konfiskimin e suksesshëm të pasurisë së fituar në mënyrë të paligjshme dhe dërgimin e mesazhit të qartë se krimi nuk është fitimprurës.

Qeveria e RMV-së, në seancën e saj të shtatëmbëdhjetë mbajtur më 23 prill 2024, e shqyrtoi dhe miratoi Informacionin për nevojën e përgatitjes së Strategjisë për forcimin e kapaciteteve për kryerjen e hetimeve financiare dhe konfiskimin e pasurisë 2025 - 2028, me konkluzionin që të formohet grup punues ndërresor për përgatitjen e strategjisë.

Detrimi për sjelljen e strategjisë së re është përcaktuar edhe në Udhërrëfyesin për sundimin e të drejtës, si një nga masat që do të kontribuojë në forcimin e kapaciteteve të institucioneve në luftën kundër krimit të organizuar.

1.3. NDËRLIDHJA ME STRATEGJI TË TJERA NË FUSHË DHE FUSHA TË NGJASHME

Strategjia 2025 - 2028 është e orientuar drejt ndërtimit të politikave cilësore dhe gjithëpërfshirëse, qëllimet e të cilave janë në përputhje me prioritetet e dokumenteve të tjera strategjike që kontribuojnë në luftën efektive kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit. Zbatimi i reformave kyçe që synojnë sigurimin e sundimit të së drejtës është proces gjithëpërfshirës dhe kompleks, i cili përfshin aspekte të ndryshme të pasqyruara në disa dokumente strategjike, me çka komplementariteti dhe ndërtimi i ndërsjellë i tyre përbëjnë kornizën e përgjigjes së shtetit në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit.

Qëllimet e përgjithshme dhe të veçanta të përcaktuara në Strategjinë 2025-2028 kontribuojnë në realizimin e qëllimeve të përcaktuara në draft **Strategjinë Nacionale Zhvillimore 2024 - 2044**², veçanërisht në qëllimet e përcaktuara në fushën strategjike "Sundimi i ligjit dhe qeverisja e mirë", Qëllimi 4: Zero korrupsion, siguri juridike dhe drejtësi jo selektive. Strategjia 2025–2028, përmes identifikimit të problemeve sistimore dhe përcaktimit të masave konkrete për institucionet përkatëse në drejtim të tejkalimit të tyre, do të kontribuojë në rritjen e efikasitetit në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, që përbën një nga prioritetet e Strategjisë Nacionale Zhvillimore 2024–2044.

Qëllimet dhe masat e përcaktuara në Strategjinë 2025-2028 janë të sinkronizuara me dokumentet e mëposhtme strategjike të miratuara nga Qeveria e RMV-së:

Strategjia Sektoriale e Zhvillimit për Gjyqësorin (2024–2028), Fusha Prioritare 2: Forcimi i kapaciteteve, efikasitetit dhe efektivitetit të institucioneve gjyqësore, ku janë përcaktuar masa konkrete për forcimin e kapaciteteve njerëzore, teknike dhe organizative të këtyre institucioneve, të cilat nga aspekti i kësaj strategjie janë thelbësore në procedurat për sigurimin e përkohshëm dhe konfiskimin e pasurisë dhe përfitimit pasuror të fituar në mënyrë të paligjshme.

Strategjia Nacionale për Luftën kundër Larjes së Parave dhe Financimit të Terrorizmit (2021–2024), në të cilën, përvëq direktivave të BE-së, janë inkorporuar edhe rekomandimet e FATF relevante për kryerjen e hetimeve financiare dhe konfiskimin e pasurisë, të konkretizuara në Qëllimin e posaçëm 11: "Të ardhurat dhe instrumentet e fituara në mënyrë të paligjshme janë konfiskuar".

Programi Nacional për miratimin e së drejtës së BE-së (2021–2025), Kapitulli 24: Drejtësia, liria dhe siguria, në të cilin forcimi i kapaciteteve të institucioneve nacionale për kryerjen e hetimeve financiare dhe konfiskimin e pasurisë është definuar si një nga qëllimet për luftë më efikase kundër krimit të organizuar, duke u përcaktuar gjithashtu masa adekuate për realizimin e tyre.

Strategjia Nacionale për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesave 2021–2024, me planin e veprimit në pjesën e Sektorit 5.2 Gjyqësori, parashikon masa dhe aktivitete për forcimin e kapaciteteve dhe përkushtimit të prokurorisë publike dhe gjyqësorit në zbulimin dhe sanksionimin e korrupsionit, si dhe forcimin e rezistencës ndaj korrupsionit brenda radhëve të tyre.

¹ Strategjia për forcimin e kapaciteteve për kryerjen e hetimeve financiare dhe konfiskimin e pasurisë për periudhën 2018–2020 dhe Strategjia për forcimin e kapaciteteve për kryerjen e hetimeve financiare dhe konfiskimin e pasurisë për periudhën 2021–2023.

² Qeveria e RMV-së, më 28.02.2024, miratoi dhe përcakttoi tekstin e Draft-Strategjisë Nacionale Zhvillimore 2022–2024.

Vendimi për përcaktimin e prioritetëve strategjike të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut për periudhën 2024–2028³, në të cilin siguri i sundimit të ligjit përcaktohet si prioritet strategjik që duhet të arrihet gjatë periudhës së ardhshme katërvjeçare, ndërsa lufta e vendosur dhe jo-selektive kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, si dhe reformat në fushën e sundimit të ligjit, përkushtimi për punë të përgjegjshme, llogaridhënëse dhe transparente të institucioneve, janë përcaktuar si një nga qëllimet për realizimin e këtij prioriteti.

Në procesin e përgatitjes të Strategjisë janë marrë në konsideratë dokumentet përkatëse të BE-së lidhur me progresin e realizuar të Republikës së Maqedonisë së Veriut⁴, përfshirë Raportin e Skriningut të KE-së për Klasterin 1 “Vlerat fundamentale”, Udhërrëfyesin për sundimin e ligjit⁵, Instrumentin për reforma dhe zhvillim 2024–2027 në lidhje me Planin e ri për rritje për vendet e Ballkanit Perëndimor⁶, si dhe Raportin e misionit vlerësues për luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, i cili u realizua në vitin 2023.

Angazhimi për arritjen e standardeve të BE-së në këtë fushë imponoi domosdoshmërisht nevojën për vlerësimin e përputhshmërisë së qëllimeve të propozuara me direktivat përkatëse të BE-së në këtë fushë⁷, si dhe me politikat dhe dokumentet strategjike të BE-së, veçanërisht:

Strategjia e BE-së për Luftën kundër Krimit të Organizuar 2021–2025⁸, e cila përcakton si qëllim “Eliminimin e fitimit të gjeneruar nga krimi i organizuar dhe parandalimin e infiltrimit të tij në ekonominë legale dhe shoqëri”. Në definimin e aktiviteteve kyçe për realizimin e këtij qëllimi, ndër të tjera, shtetet anëtare thirren që të zbatojnë në mënyrë sistematike hetime financiare për krimin e organizuar dhe sapo mjedisi financiar të tregojë praninë e mjeteve kriminale, të iniciojnë pa vonesë hetime sistematike për kthimin e pasurisë.

Plani i Veprimit i BE-së për Luftën kundër Trafikimit të Drogës dhe Krimit të Organizuar⁹, i miratuar më 18.10.2023, i cili përcakton katër fusha prioritare në të cilat BE-ja duhet të intensifikojë aktivitetet, ndër të cilat përfshihet edhe prioriteti: çrënjosjen e grupeve kriminale me rrezik të lartë përmes zbatimit të hetimeve financiare dhe digjitale, si dhe vendndodhjen e rrjeteve më të mëdha kriminale.

1.4. QASJA METODOLOGJIKE NË PËRGATITJEN E STRATEGJISË

Gjatë përcaktimit të strukturës së Strategjisë 2025–2028 është ndjekur “Metodologjia për mënyrën e përgatitjes, zbatimit, monitorimit, raportimit dhe vlerësimit të strategjive sektoriale”, si dhe udhëzimet nga “Udhëzuesi për strukturën, përmbajtjen dhe mënyrën e përgatitjes, zbatimit, monitorimit, raportimit dhe vlerësimit të strategjive sektoriale dhe ndërsektoriale”, të miratuara nga Qeveria e RMV-së më 25 maj 2022¹⁰.

Strategjia 2025–2028 bazohet në parimet e mëposhtme: (1) Parimi i harmonizimit dhe koherencës së politikave; (2) Parimi i qëndrueshmërisë fiskale të politikave; (3) Parimi i harmonizimit me politikat e Bashkimit Evropian; (4) Parimi i relevancës dhe besueshmërisë; (5) Parimi i ekonomicitetit, efikasitetit dhe efektivitetit; (6) Parimi i transparencës; (7) Parimi i llogaridhënies dhe orientimit drejt rezultateve; (8) Parimi i qëndrueshmërisë¹¹.

1.5 PROCESI I PËRFSHIRJES SË PALËVE TË INTERESUARA NË PËRGATITJEN E STRATEGJISË

³ Vendim për ndryshimin e Vendimit për përcaktimin e prioritetëve strategjike të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut për periudhën 2024–2028 (“Gazeta Zyrtare e RMV-së” nr. 177/2024)

⁴ Raporti i Komisionit Evropian për progresin e Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2023; Raporti i Komisionit Evropian për progresin e Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2022

⁵ Udhërrëfyesi për sundimin e ligjit është hartuar në përputhje me udhëzimet e shërbimeve profesionale të KE-së dhe pasqyron mangësitë e konstatuara në Raportin e Skriningut të KE-së për Klasterin “Vlerat Themelore”

⁶ Plani i rritjes për Ballkanin Perëndimor është publikuar nga KE më 8 nëntor 2023,

⁷ Direktiva (BE) 2024/1260 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 24 prill 2024, për rikuperimin dhe konfiskimin e pasurisë; Vendimi i Këshillit 2007/845/JHA, lidhur me bashkëpunimin ndërmjet zyra për rikuperimin e pasurisë të shteteve anëtare të BE-së në fushën e gjurmimit dhe identifikimit të të ardhurave nga veprat penale ose pasurive të tjera të lidhura me to

⁸ Strategjia e BE-së për luftën kundër krimit të organizuar 2021–2025, Bruksel, 4.4.2021

⁹ Komunikim i Komisionit Evropian drejtuar Parlamentit Evropian dhe Këshillit për Planin e Veprimit të BE-së për luftën kundër trafikimit të drogës dhe krimit të organizuar, Bruksel, 18.10.2023, COM (2023) 641

¹⁰ “Gazeta Zyrtare e RMV-së” nr. 122/22

¹¹ Udhëzuesi për strukturën, përmbajtjen dhe mënyrën e përgatitjes, zbatimit, monitorimit, raportimit dhe vlerësimit të strategjive sektoriale dhe ndërsektoriale, neni 3

Hartimi i Strategjisë 2025–2028 u zhvillua përmes procesit transparent dhe gjithëpërfshirës.

Përgatitja e këtij dokumenti strategjik është rezultat i angazhimit të grupit ndërrresorial të punës, të formuar për këtë qëllim, ku të gjitha institucionet relevante u përfshinë në procesin e planifikimit dhe përcaktimit të masave të ardhshme që synojnë forcimin e sistemit për konfiskimin e pasurisë së fituar në mënyrë të paligjshme.

Grupi ndërrresorial i punës, i formuar me aktvendim të ministrit të Punëve të Brendshme, bazuar në konkluzionin paraprak të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, përbëhej nga përfaqësues të emëruar nga institucionet e mëposhtme: Kabineti i Zëvendëskryetarit të Qeverisë i angazhuar për Politikën e Qeverisjes së Mirë, MPB, MD, MF, MF – DD, MF – DPF, MF – DAP, MTD, AAPS, Këshilli Gjyqësor i RMV-së, Prokuroria Publike e RMV-së dhe Gjykata Themelore Penale Shkup.

2. ANALIZË E GJENDJES

2.1. Rezultatet nga zbatimi i strategjisë së mëparshme

Miratimi i Strategjisë për forcimin e kapaciteteve për kryerjen e hetimeve financiare dhe konfiskimin e pasurisë për periudhën 2021–2023 (në tekstin në vijim: Strategjia 2021–2023), së bashku me Planin e veprimit për zbatimin e saj, ishte një nga aktivitetet kyçe të parashikuara në dokumentet strategjike të Qeverisë së RMV-së në luftën kundër korrupsionit dhe në procesin e integritetit evropian¹². Aktivitetet e përcaktuara në strategjinë në fjalë ishin të orientuara drejt arritjes së qëllimeve strategjike në vijim: forcimi institucional dhe kadrovik i kapaciteteve të institucioneve kompetente për kryerjen e hetimeve financiare; bashkëpunimi ndërinstitucional dhe statistika; krijimi i Zyrës efektive për Kthimin e Pasurisë (Zyra ARO); forcimi dhe rritja e efikasitetit të Agjencisë për Menaxhimin e Pasurisë së Sekuestruar; vendosja e sistemit të integruar dhe ndërdisiplinor të trajnimeve dhe ndërtimit të kompetencave, si dhe shfrytëzimi i përparësive të interoperabilitetit dhe qasjes në bazat e të dhënave.

Bazuar në vlerësimin e kryer të nivelit të zbatimit të masave të përcaktuara në strategjinë e lartpërmendur¹³, si konstatim i përgjithshëm imponohet konkluzioi se Strategjia 2021–2023 është zbatuar pjesërisht. Si faktorë kyç që kanë ndikuar në nivelin e zbatimit mund të veçohen: afati i shkurtër për zbatimin e Strategjisë 2021–2023; procedurat e gjata të konsultimit ndërmjet palëve të interesuara në procesin e miratimit të ligjeve kyçe në këtë fushë; si dhe mungesa e mjeteve financiare të mjaftueshme si kusht i domosdoshëm për realizimin e qëllimeve të përcaktuara. Megjithatë, duhet pasur parasysh se periudha e zbatimit të Strategjisë 2021–2023 filloi menjëherë pas pandemisë së virusit Korona, si dhe pas krizës ekonomike dhe energjetike pasuese, të cilat kontribuan në reduktimin e burimeve financiare në dispozicion dhe në riorientimin e tyre drejt realizimit të prioriteteve të tjera nacionale.

Nga ana tjetër, nëse merret në konsideratë rritja e vazhdueshme e numrit të hetimeve financiare të zbatuara dhe rritja e vlerës së pasurisë së konfiskuar, që në thelb përbën qëllimin parësor të strategjisë, mund të konstatohet se përmes masave të zbatuara është arritur progres.

Zbatimi i saj kontribuoi në rritjen e ndërgjegjësimit dhe përgjegjësisë së të gjitha institucioneve relevante për zbatimin e aktiviteteve për gjetjen, identifikimin, ndjekjen dhe sigurimin e përkohshëm të pasurisë dhe përfitimeve pasurore të fituara në mënyrë të paligjshme, si një parakusht i rëndësishëm për konfiskimin e suksesshëm të mëvonshëm. Përfshirja e të gjitha institucioneve relevante mundësoi krijimin e përgjigjes efektive nacionale, e cila duhet të zhvillohet më tej përmes strategjisë së re dhe planit adekuat të veprimit. Aktivitetet e Komisionit Nacional për monitorimin e zbatimit të Strategjisë për forcimin e kapaciteteve për kryerjen e hetimeve financiare dhe konfiskimin e pasurisë përbëjnë një nga arritjet kryesore në zbatimin e Strategjisë 2021–2023 dhe janë shtytësi kryesor në realizimin e qëllimeve dhe aktiviteteve të përcaktuara.

Në fushën e parë **“Forcimi institucional dhe kadrovik i institucioneve për kryerjen e hetimeve financiare”**, është konstatuar progres në aspektin juridik, i cili reflektohet përmes miratimit të ndryshimeve në KP¹⁴ (në pjesën e zgjerimit të katalogut të veprave penale për të cilat mund të zbatohet instituti i konfiskimit të zgjeruar), si dhe përmes miratimit të

¹² “Plani për Luftën kundër Korrupsionit” dhe “Agjenda Evropa në Shtëpi”

¹³ Vlerësimi i Strategjisë 2021–2023 u realizua nga një ekspert i jashtëm, me kërkesë të Komisionit Nacional dhe me mbështetjen e GIZ Shkup, në kuadër të Programit Global për përballimin e flukseve

¹⁴ “Gazeta Zyrtare e RMV-së” nr. 188/2023

procedurave standarde operative për kryerjen e hetimeve financiare në MPB, DD dhe DPF. Shumica e aktiviteteve që janë realizuar pjesërisht kanë të bëjnë me forcimin material, teknik dhe kadrovik të MPB-së, DD-së dhe DPF-së, të cilat në thelb përbëjnë aktivitete të vazhdueshme. Aktivitetet e përcaktuara lidhen me mosmiratimin e ndryshimeve në Ligjin për Punët e Brendshme, Ligjin për Drejtorinë Doganore dhe Ligjin për Policinë Financiare, të cilat kishin për qëllim sigurimin e mbajtjes së përqindjes nga shitja e pasurisë së konfiskuar në buxhetet e këtyre institucioneve. Megjithatë, si rezultat i konsultimeve intensive ndërinstitucionale në kuadër të Komisionit Nacional, kjo mundësi u realizua përmes miratimit të Ligjit për Menaxhimin me Pasurinë e Konfiskuar, Përfitimit Pasuror dhe Sendeve të Sekuestruara në Procedurë Penale dhe Kundërvajtëse, i cili u siguroi institucioneve të përmendura bazën ligjore për të mbajtur përqindje nga shitja e pasurisë së konfiskuar. Si aktivitete të përcaktuara mund të evidentohen gjithashtu zbatimi i softuerit për kontroll dhe hetime në Drejtorinë Doganore dhe sigurimi i kapaciteteve hapësinore për Njësinë e Hetimeve Financiare në MPB.

Në fushën **“Bashkëpunimi ndërresorjal dhe statistika”**, aktivitetet lidhur me formimin e Komisionit Nacional janë realizuar plotësisht, ndërsa është vërejtur realizim i pjesshëm në forcimin e kapaciteteve të qendrave hetimore dhe regjistrimin e procedurave për hetimet financiare. Si aktivitete të përcaktuara në këtë fushë evidentohen: krijimi i bazës elektronike të të dhënave në Zyrën ARO dhe vendosja e mbështetjes softuerike në PPRMV-së (TRAK REKORD/regjistrimi i procedurave për hetimet financiare). Rrethanë që kishte ndikim vendimmarrës në mosrealizimin e TRAK REKORD/regjistrimit të hetimeve financiare në procedurat për rastet e krimit të organizuar ishte vonesa në implementimin e Programit IPA 3, brenda të cilit ishte parashikuar krijimi i tij. Aktivitetet për harmonizimin e metodologjive TRAK REKORD për monitorimin e procedurave për rastet e krimit të organizuar, korrupsionit dhe pastrimit të parave janë në zhvillim. Njëkohësisht, po kryhen aktivitete për përmirësimin e pajisjeve IT, për përdorimin e tyre në mënyrë që të gjenerohen raporte statistikore të harmonizuara. Në kuadër të projektit IPA 2021 “Vendosja e sistemit elektronik për mbajtjen e regjistrave në institucionet e zbatimit të ligjit (LERMS)”, i cili filloi të implementohet në shtator 2024, kanë nisur aktivitetet të projektit për realizimin e gap analizës (gap analysis), duke vlerësuar gjendjen aktuale të vendosjes institucionale dhe infrastrukturës IT të përdorur për menaxhimin e regjistrave të çështjeve penale, bazuar në këtë analizë do të zhvillohen zgjidhje softuerike, me të cilat do të vendoset TRAK REKORD — mënyrë e harmonizuar e mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave statistikore për monitorimin e procedurave penale për rastet e krimit të organizuar, korrupsionit dhe pastrimit të parave, përfshirë edhe të dhënat për hetimet financiare.

Aktivitetet që nuk janë realizuar varen drejtpërdrejt nga miratimi (ose mosmiratimi) i ligjeve kyçe, të cilat shërbejnë si bazë për zbatimin e tyre, veçanërisht në fushat e mëposhtme:

III Zyra efektive për kthimin e pasurisë (Zyra ARO), fushë që përmbledh aktivitete të cilat objektivisht mund të realizohen vetëm pas miratimit të Ligjit për Zyrën për Kthimin e Pasurisë. Gjatë periudhës së zbatimit të Strategjisë 2021–2023, ligji i përmendur u hartua dhe procedura për miratimin e tij u fillua, por ligji nuk u miratua nga ana e Kuvendit të RMV-së, me çka u pamundësua realizimi i aktiviteteve të tjera nga kjo fushë. Ligji për Zyrën për Kthimin e Pasurisë (Zyra ARO)¹⁵ u miratua gjatë vitit 2024, përkatësisht pas periudhës së zbatimit të Strategjisë 2021–2023.

IV Përforcimi dhe rritja e efikasitetit të Agjencisë së Menaxhimit me Pasuri të Sekuestruar, ku numri më i madh i aktiviteteve varet nga miratimi i Ligjit të ri për Menaxhim me Pasuri të Konfiskuar, Përfitimit Pasuror dhe Sendeve të Sekuestruara në Procedurë Penale dhe Kundërvajtëse. Gjatë periudhës së zbatimit të Strategjisë 2021–2023, ligji i përmendur nuk u miratua, përkatësisht i njëjti u miratua gjatë vitit 2024¹⁶.

Në fushën **“Sistem i integruar dhe ndërdisiplinor i trajnimeve dhe ndërtimit të kompetencave”** janë zbatuar numër i madh trajnimesh; trajnimi për (PSO) për kryerjen e hetimeve financiare është realizuar pjesërisht, pasi është zbatuar me intensitet të ndryshëm në institucionet (MPB, DD dhe DPF), ndërsa si aktivitete të përcaktuara janë evidentuar: përgatitja e programeve për trajnim bazë dhe programit për trajnim të vazhdueshëm.

Në fushën **“Interoperabiliteti”**, numër i madh i aktiviteteve zbatohen në mënyrë të vazhdueshme.

¹⁵ Gazeta Zyrtare e RMV-së nr.66/2024

¹⁶ Gazeta Zyrtare e RMV-së nr.64/2024



Pasqyrë tabelare e shkallës së zbatimit të Strategjisë 2021–2023

2.2. ANALIZË E GJENDJES AKTUALE NË FUSHË DHE NË FUSHA TË TJERA TË NGJASHME TË POLITIKAVE

PASQYRË E PËRGJITHSHME:

Procesi i pashmangshëm dhe gjithëpërfshirës i globalizimit monetar, financiar dhe ekonomik mundëson shumë përfitime nga aspekti ekonomik, por njëkohësisht krijon mundësi të reja për veprim kriminal dhe përfitim për krimin e organizuar. Grupet e organizuara kriminale përdorin përfitimet e mëdha të paligjshme për të infiltruar në ekonominë legale dhe në institucionet publike, edhe atë përmes korrupsionit, erozionit të sundimit të ligjit dhe të të drejtave themelore, duke minuar besimin e qytetarëve tek organet shtetërore. Tregtia e paligjshme me drogë, armë, trafikimin e njerëzve dhe kontrabanda me migrantë janë ndër bizneset kriminale më fitimprurëse, që gjenerojnë përfitime në nivel vjetor prej miliarda eurosh. Sipas të dhënave të Europolit, vlerësohet se të ardhurat kriminale nga nëntë tregjet kryesore kriminale në Bashkimin Evropian arrijnë 139 miliardë euro, që korrespondojnë me 1% të prodhimit të brendshëm bruto të Unionit. Megjithatë, përqindja e të ardhurave kriminale që institucionet ligjzbatuese në BE kanë arritur t'i konfiskojnë nga duart e kriminelëve mbetet nën 2% të të ardhurave të vlerësuara vjetore të krimit të organizuar.¹⁷

Për më tepër, për të mundësuar funksionimin dhe avancimin e motorit të krimit të organizuar, tre komponentë kryesore duhet të veprojnë në kapacitet të plotë:¹⁸ *larja e parave, realizimi i të ardhurave kriminale dhe mundësia për t'i investuar ato në flukset legale, si dhe korrupsioni që u mundëson kriminelëve qasje tek informacionet dhe pushteti.*¹⁹ Në lidhje me rrezikun nga investimi i të ardhurave kriminale, Europol vlerëson se të gjitha llojet e bizneseve legale në BE janë potencialisht të cenueshme nga krimi serioz dhe i organizuar. Të dhënat shqetësuese tregojnë se mbi 80% e rrjeteve kriminale aktive në BE përdorin strukturat e bizneseve legale për aktivitetet e tyre kriminale, ndërsa gjysma e këtyre rrjeteve tashmë kanë themeluar strukturat e tyre të bizneseve legale.²⁰ Për më tepër, digjitalizimi dhe zhvillimi informatik-teknologjik, dhe veçanërisht rëndësia në rritje e financave digjitale, kanë sjellë set të ri sfidash, si përdorimi i paligjshëm i kriptovalutave, darknet-i dhe vjedhja e identiteteve, të cilat përdoren gjithnjë e më shumë nga kriminelët dhe vështirësojnë identifikimin e origjinës së parave.

RMV-ja përballlet me të njëjtat sfida. Krimi i organizuar në vendin tonë karakterizohet nga veprimi i grupeve të organizuara

¹⁷ Vlerësimi i kërcënimeve nga krimi serioz dhe i organizuar në BE për 2021 (EU SOCTA), 12 prill 2021

² Europol, Qendra Evropiane për Krimin Financiar dhe Ekonomik: Ana tjetër e monedhës, 2023

¹⁸ Europol, Qendra Evropiane për Krimin Financiar dhe Ekonomik: Ana tjetër e monedhës, 2023

²⁰ Europol, Vlerësimi i kërcënimeve nga krimi serioz dhe i organizuar në BE për 2021 (EU SOCTA), 12 prill 2021 <https://www.europol.europa.eu/activities-services/main-reports/european-union-serious-and-organised-crime-threat-assessment>.

krimiale që janë pjesë e rrjeteve më të gjera rajonale dhe ndërkombëtare kriminale. Ato karakterizohen nga struktura vertikale hierarkike, të vendosura përmes lidhjeve dhe interesave familjare, fisnore dhe biznesore. Karakteristikë është shfaqja e grupeve polikriminale (grupe të përfshira në më shumë fusha kriminale), ku gjatë vitit 2023, më të përhapura kanë qenë grupet e organizuara kriminale në fushën e tregtisë së paligjshme të drogës dhe armëve, trashëgimisë kulturore dhe krimit ekonomik, mashtrimeve tatimore dhe larjes së parave.²¹

Sipas vlerësimit të fundit nacional të kërcënimeve nga krimi i organizuar, në vendin tonë ndërtimtaria, organizimi i lojërave të fatit, hoteleria, si dhe ofrimi i shërbimeve të mbrojtjes fizike përmes agjencive të sigurimit paraqesin sektorë të cenueshëm nga infiltrimi i krimit të organizuar. Po ashtu, sektor i cenueshëm konsiderohen edhe fabrikat për kultivimin e “cannabis sativa” në kushte të kontrolluara, si dhe sektori energjetik, veçanërisht me thellimin e krizës energjetike.²²

Analiza e të dhënave e realizuar tregon se shpërdorimi i detyrës zyrtare, tregtia e paligjshme e drogës, evazioni fiskal dhe kontrabanda me migrantë janë vepra penale të cilat përcaktohen me nivel të lartë kërcënimi për larjen e parave. Janë identifikuar sektori bankar, shërbimet për transfer të shpejtë të parave, vetëqeverisja lokale, si dhe subjektet juridike nga sektori privat me veprimtari të ndryshme, si sektorët më të ekspozuar ndaj rrezikut të larjes së parave.²³

Korrupsioni është element integruar në pothuajse çdo lloj të krimit të organizuar, i cili dëmton dhe dobëson tre shtyllat kryesore mbi të cilat mbështetet stabiliteti i shtetit: sigurinë, ekonominë dhe politikën. Sipas të dhënave të Europolit, pothuajse 60% e grupeve të organizuara kriminale janë të përfshira në aktivitete korruptive, përmes të cilave përpiqen që të infiltrohen në të gjitha sferat e sistemit legal shoqëror. Në Raportin e Transparency International për vitin 2023, Indeksi i perceptimit të korrupsionit, i cili përfaqëson një nga indikatorët për përhapjen e korrupsionit në sektorin publik, e rendit RMV-në në vendin e 76-të.



Duke marrë parasysh praktikat e mira evropiane, është e nevojshme të rritet transparenca në menaxhimin e parave të konfiskuara. Në këtë drejtim, është e nevojshme të bëhet analizë e modelit për formimin e fondit/llogarisë së veçantë, në të cilin do të transferoheshin mjetet që rrjedhin nga sekuestrimi dhe konfiskimi i pasurisë, ose pjesë e tyre. Përmes këtij modeli, Qeveria do të mund të sigurojë transparencë të plotë lidhur me burimet dhe përdorimin e mjeteve, monitorim më të mirë të përdorimit të tyre, si dhe llogaridhënie ndaj qytetarëve për mënyrat se si përdoren këto burime për qëllime shoqërore dhe të tjera të dobishme. Menaxhimi transparent i këtyre mjeteve do të kontribuojë në rritjen e besimit të publikut tek institucionet shtetërore, si dhe në rritjen e efikasitetit të tyre.

PASQYRË E GJENDJES NË FUSHA TË ÇAKTUARA:

²¹ Raporti vjetor i MPB-së për vitin 2023

²² Vlerësimi nacional i kërcënimeve nga krimi i organizuar, 2020

²³ Drejtoria e Zbulimit Financiar: Raporti mbi vlerësimin e riskut nga larja e parave dhe financimi i terrorizmit, 2020

2.2.1. Gjetja, identifikimi dhe monitorimi i pasurisë së fituar në mënyrë të paligjshme në vend dhe jashtë vendit

2.2.1.1. HETIMET FINANCIARE

Duke pasur parasysh se prioritet i krimit të organizuar është arritja e fitimit, qasja “ndiqi paratë” është mënyra më efektive për të gjetur pasurinë e fituar në mënyrë të paligjshme dhe për ta konfiskuar atë. Kjo qasje nënkupton forcimin e vazhdueshëm të kapaciteteve të institucioneve për kryerjen e hetimeve financiare në nivel nacional, përmes investimeve në burime dhe trajnime, me qëllim krijimin e sistemit për zbatimin efikas të hetimeve financiare si mjet themelor për zbulimin, identifikimin, ndjekjen dhe sigurimin e përkohshëm të pasurisë së fituar në mënyrë të paligjshme për konfiskim. Një nyje e rëndësishme në procesin e gjetjes dhe identifikimit të pasurisë së fituar në mënyrë të paligjshme brenda vendit dhe jashtë tij është Zyra për Kthimin e Pasurisë (Zyra ARO).

Hetimet financiare të integruara dhe hetimet e ngjarjes penale përbëjnë aspekte të ndryshme të procesit të vetëm, që është hetim i plotë dhe efikas i veprës penale. Hetimi financiar paraqet grup aktivitetesh hetimore që përfshijnë gjetjen, identifikimin dhe ndjekjen e pasurisë dhe përfitimeve pasurore që rrjedhin nga vepra penale ose lidhen me të, si dhe pasurinë me origjinë të paligjshme (për qëllimet e konfiskimit të zgjeruar), me qëllim sigurimin e përkohshëm dhe konfiskimin e tyre. Hetimi financiar shqyrton të gjitha aspektet financiare të lidhura me vepër të caktuar penale për të siguruar dëshmi, përkatësisht dokumentimin e lëvizjes së parave dhe pasurisë në kontekstin e veprës penale që po hetohet. Hetimi financiar për pasurinë me origjinë të paligjshme kryhet për veprat penale të katalogut sipas nenit 98-a të KP-së.

Organe kompetente për kryerjen e hetimeve financiare:

I. Prokuroria Publike, organ i pavarur shtetëror që ndjek penalisht kryerësit e veprave penale për të cilat ndjekja ndërmerret sipas detyrës zyrtare. Prokurori publik udhëheq procedurën parahetimore dhe hetimore dhe ka në dispozicion policinë gjyqësore. Për nevojat e procedurës penale, për rajonin e një ose më shumë prokurorive publike, formohen qendra hetimore të prokurorisë publike.²⁴

Hetimet financiare i zhvillojnë pjesëtarët e policisë gjyqësore të deleguar në qendrat hetimore të prokurorive publike, si dhe pjesëtarët e policisë gjyqësore në institucionet përkatëse (MPB, DD, DPF), në koordinim dhe sipas udhëzimeve të prokurorit publik kompetent.

Në Raportin e fundit për progresin e vendit²⁵, Komisioni Europian konstaton se qendrat hetimore funksionojnë, por ende nuk disponojnë burime të mjaftueshme njerëzore dhe financiare, si dhe pajisje të përshtatshme për funksionim të rregullt.

II. Ministria e Punëve të Brendshme, funksioni themelor i së cilës është parandalimi i kryerjes së veprave penale dhe kundërvajtjeve, zbulimi dhe kapja e kryerësve të tyre, si dhe ndërmarrja e masave të tjera të përcaktuara me ligj për ndjekjen e kryerësve të këtyre veprave. Në strukturën organizative të Njësisë për luftimin e krimit të organizuar dhe serioz është e strukturuar një Njësi speciale për hetime financiare, e cila është e pozicionuar në Sektorin për hetime kriminalistike.

Çdo zyrtar policor që zhvillon hetim kriminalistik për vepër penale që gjeneron të ardhura të paligjshme është i obliguar të zhvillojë edhe hetim financiar,²⁶ ndërsa Njësia për hetime financiare është kompetente për kryerjen e hetimeve financiare komplekse dhe më të ndërlikuara dhe përfshirja e nëpunësve policorë nga kjo njësi bëhet sipas kushteve të përcaktuara në PSO për hetim financiar. Nëse analizohen të dhënat statistikore për kryerjen e hetimeve financiare në periudhën e kaluar, vërehet rritje e vazhdueshme e numrit të hetimeve financiare ndaj personave juridik dhe fizik.

Ministria e Punëve të Brendshme	Numri i hetimeve financiare	Persona fizik	Persona juridik
------------------------------------	--------------------------------	---------------	--------------------

²⁴ Në bazë të vendit të Prokurorit Publik të RMV-së, janë formuar 4 qendra hetimore: qendra hetimore në PThP NKOK, PThP Shkup, PThP Kumanovë dhe PThP Tetovë.

²⁵ Komisioni Evropian, Raporti për RMV për vitin 2023, SVD (2023) 693, Bruksel, 08.11.2023

²⁶ PSO për kryerjen e hetimeve financiare në MPB

	—		
Viti 2021	6	6	
Viti 2022	15	70	30
Viti 2023	3	51	1
GJITHSEJ:	24	127	31

III. Drejtoria Doganore organ në përbërje të Ministrisë së Financave me status të personit juridik të posaçëm dhe pjesë e policisë gjyqësore, përgjegjëse për zbatimin e masave hetimore dhe të zbulimit me qëllim parandalimin, zbulimin dhe hetimin e veprave penale dhe veprave penale doganore. Shërbimi i hetimeve financiare është njësi e specializuar për kryerjen e hetimeve financiare dhe e njëjta është pozicionuar në Sektorin e Kontrollit dhe Hetimeve në Drejtorinë Doganore.

Drejtoria Doganore	Numri i hetimeve financiare	Persona fizik	Persona juridik
	—		
Viti 2021	7	9	6
Viti 2022	14	22	9
Viti 2023	20	22	12
GJITHSEJ:	41	53	27


IV. Drejtoria e Policisë Financiare, organ në përbërje të Ministrisë së Financave me status të personit juridik dhe pjesë e policisë gjyqësore, kompetente për ndjekjen penale të autorëve të veprave penale nga fusha e krimit të organizuar financiar dhe veprave penale që ndiqen sipas detyrës zyrtare ²⁷, si dhe veprave tjera penale sipas KP me të cilat është marrë përfitimi i paligjshëm pasuror me vlerë të konsiderueshme ose është shkaktuar dëm në Buxhetin e RMV. Në kompetencë të DPF është edhe mbrojtja e interesave financiare të BE-së nëpërmjet zbulimit dhe hetimit kriminalistik të veprave penale që lidhen me programet e BE-së që vendi ynë i merr nga Buxheti i BE-së. Njësia e hetimeve financiare u formuar në DPF në vitin 2019, por duke pasur parasysh kompetencat ligjore të DPF-së, hetimet financiare i kryen të gjithë inspektorët financiarë në DPF

Drejtoria e Policisë Financiare	Numri i hetimeve financiare	Persona fizik	Persona juridik
	—		
Viti 2021	2	—	

²⁷ KP, "Shoqata kriminale" neni 394, "Shpërdorim i pozicionit dhe autoritetit zyrtar" neni 353, "Punë e pavetëdijshme në shërbim" neni 353-v, "Pastrim parash dhe të ardhura tjera nga vepra penale" neni 273, "Tregti e paligjshme" neni 277, "Mashttrim në dëm të mjeteve të Bashkësisë Evropiane" neni 279-a, "Mashttrim" neni 247, "Shmangie e tatimit" neni 279, "Falsifikim ose shkatërrim i librave të biznesit" neni 280, "Përvetësim në shërbim" neni 354, "Falimentim i rremë" neni 254, "Kontrabandë" neni 278

Viti 2022	24		
Viti 2023	122	98	
GJITHSEJ:			—

Njësitë për kryerjen e hetimeve financiarë në MPB, DPF dhe DD, në mënyrë të pavarur dhe në koordinim dhe sipas udhëzimeve të prokurorit publik, janë të detyruara ti ndërmarrin të gjitha masat dhe aktivitetet e nevojshme për sigurimin e dëshmive të pronës së marrë në mënyrë të paligjshme dhe përfitimeve pasurore me kryerjen e veprës penale që është objekt i hetimit dhe për pronën me origjinë të paligjshme për qëllimet e konfiskimit të zgjeruar, si dhe të japin iniciativë për shqiptimin e masave për sigurimin e përkohshëm të tyre me qëllim të konfiskimit. Njësitë e shënuara sigurojnë dhe kryejnë analiza dhe vlerësime të numrit të madh të të dhënave dhe informacioneve financiare me përdorimin e metodave analitike dhe komperative, ndërsa kanë autorizim të zbatojnë edhe masa të veçanta hetimore me urdhër paraprak të siguruar nga prokurori publik ose gjykata kompetente me qëllim sigurimin e dëshmive materiale për kryerjen me sukses të procedurës penale.



Prezantimi grafik i hetimeve financiare të zbatuara në MPB, DD dhe DPF në vitet 2021, 2022 dhe 2023

Me miratimin e **PSO-së për kryerjen e hetimeve financiare në MPB, DD dhe DPF** mundësoi veprim të unifikuar të të punësuarve në këto tre institucione dhe kontriboi në përfundimin e procesit të identifikimit dhe monitorimin e pasurisë së fituar në mënyrë të paligjshme. Megjithatë, është detektuar nevoja për rregullim ligjor të aspekteve të caktuara të hetimit financiar.

Konstatime të përfshira në raporte relevante ndërkombëtare:

Në raportin për RMV-së nga ana e MONEYVAL,²⁸ pas zbatimit të raundit të pestë të vlerësimit, është vërejtur se edhe pse janë arritur rezultate të caktuara, në lidhje me hetimet dhe akuzimet për pastrimin e parave, organet e ndjekjes dhe prokurorët duhet të zbatojnë sistematikisht hetime financiare paralele dhe të përqendrohen në raste më komplekse të pastrimit të parave që përfshijnë krimin e organizuar, në veçanti trafikimin e drogës, trafikimin e qenieve njerëzore, si dhe evazionin fiskal dhe korrupsionin. MONEYVAL gjithashtu u bën thirrje autoriteteve që të zbatojnë sistematikisht parimin "follow the money" që të përmirësohen nivelet e konfiskimit.

Duke analizuar situatën aktuale në RMV në këtë fushë, KE ²⁹ arrin në të njëjtin konkludim se hetimet financiare nuk zbatohen në mënyrë sistematike dhe paralelisht me hetimet penale që nga fillimi dhe efektiviteti i tyre mbetet ende i kufizuar. Rekomandimi i KE-së është të përfordohen kapacitetet për kryerjen e hetimeve financiare paralelisht me hetimet penale dhe në veçanti të përmirësohen teknikat e hetimit financiar të policisë dhe prokurorëve.

Sfidat dhe dobësitë:

I. Menaxhimi me burimet njerëzore

Karakteristikë e të gjitha njësive të specializuara për kryerjen e hetimeve financiare (MPB, DD dhe DPF) është mungesa e kuadrit. Është e nevojshme të investohet në kuadrin profesional që kryen hetime financiare, jo vetëm në aspektin e plotësimit të pozicioneve të parashikuara, por edhe në përmirësimin dhe specializimin e tyre të vazhdueshëm. Krijimi i

²⁸ Komiteti i ekspertëve për vlerësimin e masave kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit

²⁹ Raporti i skriningut për grupin 1 "Vlerat fundamentale", 20.07.2023, f. 73

stafit cilësor që ka njohuritë dhe aftësitë për të qenë në gjendje të gjurmojë të ardhurat kriminale është proces shumëvjeçar, i cili duhet të shoqërohet me politikë të përshtatshme për mbajtjen e tyre. Kriteret për përzgjedhjen e kuadrit në njësitë e specializuara të shënuara duhet të rriten dhe të unifikohen në MPB,DD dhe DPF. Institucionet e zbatimit të ligjit duhet të zhvillojnë qasje strategjike për përzgjedhjen, përmirësimin dhe mbajtjen e stafit profesional, veçanërisht duke pasur se prej tyre rekrutohen edhe kuadro në qendrat e hetimit.

II. Sistemi i integruar i trajnimit

Në periudhën e kaluar, janë zbatuar numër i madh trajnimesh që kanë kontribuar në rritjen e njohurive dhe aftësive të të punësuarve në këto njësi, gjë që është e dukshme edhe nga rritja e vazhdueshme e numrit të hetimeve financiare. Megjithatë, sfida që të krijohet sistem trajnimi i integruar dhe ndërdisiplinor që do të sigurojë trajnim bazë dhe të vazhdueshëm për kryerjen e hetimeve financiare për punonjësit në njësitë e specializuara për kryerjen e hetimeve financiare (MPB,DD dhe DPF) dhe qendrat e hetimit është ende aktuale. Sistemi i shënuar duhet të sigurojë proces të vazhdueshëm dhe të përhershëm të përsosjes profesionale dhe zhvillimit profesional, zhvillimit të kompetencave dhe përvetësimit të njohurive dhe aftësive të personave përgjegjës për kryerjen e hetimeve financiare.

III. Pajisjet materiale dhe teknike:

Duke pasur parasysh që grupet e krimit të organizuar veprojnë transnacional, duke përdorur modus operandi dhe teknologji të reja, marrëveshja efektive një reagim efektiv urdhëron institucionet nacionale (MPB, DD dhe DPF) të jenë të pajisura me mjete të specializuara për zbulimin e tyre. Pajisjet aktuale materiale dhe teknike të institucioneve nuk janë në hap me teknologjitë e reja dhe nuk i plotësojnë plotësisht nevojat e institucioneve të zbatimit të ligjit. Hetimet financiare nuk kryhen në potencialin e tyre optimal, pjesërisht për shkak të pajisjeve të pamjaftueshme materiale dhe teknike të institucioneve për kryerjen e hetimeve komplekse dhe të gjera. Është e nevojshme Investim i vazhdueshëm në modernizimin e infrastrukturës dhe pajisjeve, të cilat do të mundësojnë reagim të shpejtë dhe sistematik dhe përgjigje të përshtatshme ndaj aktiviteteve kriminale të grupeve të krimit të organizuar. Situata aktuale tregon se sigurimi i kapaciteteve të mjaftueshme hapësinore është sfidë me të cilën përballen të gjitha institucionet kompetente për kryerjen e hetimeve financiare, dhe e cila është më e theksuar në MPB.

IV. Interoperabiliteti

Qasja e shpejtë dhe konspirative në të dhëna dhe informacione mbi gjendjen financiare dhe pasurore të personave fizik dhe personave juridikë që janë lëndë e hetimit financiar është me rëndësi thelbësore për kryerjen me sukses dhe në kohë të hetimeve efektive financiare. Edhe pse platforma e interoperabilitetit është plotësisht funksionale, ende ekziston shkallë e ndryshme e shfrytëzimit të potencialit të saj nga institucionet kompetente shtetërore (MPB,DD dhe DPF). Niveli i digjitalizimit të regjistrave, disponueshmëria e kapaciteteve për qasje në platformën e theksuar ndryshon mes institucioneve të lartpërmendura, gjë që në fund të fundit rezulton në shkallë të ndryshme të qasjes në bazat e të dhënave nga institucionet e tjera.

Sipas KE-së,³⁰ mungesa e qasjes së drejtpërdrejtë të institucioneve të zbatimit të ligjit në bazat e të dhënave të ndryshme rezulton në ngadalësi në ofrimin e informacionit përkatës dhe përbën rrezik për besueshmërinë e hetimeve.

2.2.1.2 Zyra e Kthimit të Pasurisë (Zyra e ARO-së)

Përpjekjet individuale të vendeve për menaxhim me krimin e organizuar nuk janë të mjaftueshme për të menaxhuar me natyrën transnacionale të grupeve të krimit të organizuar, duke pasur parasysh se 70% të grupeve kriminale janë aktive në më shumë se tre vende³¹. Vendimi i Këshillit 2007/845/PVR³² e vendos obligimin që vendet anëtare të BE-së të krijojnë ose të caktojnë zyrë të kthimit të pasurisë si pika kontakti qendrore nacionale që të lehtësohet monitorimi i pronës që rrjedhin nga veprat penale.

³⁰ Raporti i shqyrtimit të Komisionit Evropian për grupin e vlerave fundamentale

³¹ Europol, European Union Serious and Organized Crime Threat Assessment “[A Corrupting Influence: The infiltration and undermining of Europe’s economy and society by organised crimes](#)”, (2021).

³² Vendimi i Këshillit 2007/845/PVR i 6 dhjetorit 2007 për bashkëpunim ndërmjet shërbimit për kthimin e mjeteve të vendeve anëtare në fushën e monitorimit dhe identifikimit të të ardhurave ose pasurisë tjetër të lidhur me veprat kriminale L 332/103, 18.12.2007

Zyra e kthimit të pasurisë (në tekstin e mëtejshëm: Zyra e ARO-së) në RMV është themeluar në vitin 2019 në kuadër të Prokurorisë Publike. Kompetenca e Zyrës së ARO-së në RMV është e rregulluar me Ligjin për Zyrën e Kthimit të Pasurisë (Zyra e ARO-së)³³ në të cilin janë përfshirë dispozitat e Vendimit të Këshillit 2007/845/PVR të 6 dhjetorit 2007. Në këtë kontekst, Zyra e ARO-së ka kompetencë të ndërmarrë aktivitete për marrje të informacioneve dhe të dhëna për gjetjen dhe identifikimin e të ardhurave dhe pasurisë ose përfitimeve të tjera pasurore në vend ose jashtë vendit në lidhje me shtetas vendas ose rezident në RMV, person pa shtetësi ose i huaj, si dhe për qëllimet e procedurës së konfiskimit pa përcaktimin e përgjegjësisë penale, të cilat kanë dalë ose janë në lidhje me vepra penale. Në kuadër të Kompetencave të Zyrës së ARO-s përfshihet shkëmbimi i informacioneve dhe të dhënave dhe shkëmbimin e përvojave dhe praktikave më të mira me Zyrat e huaja të ARO-s për shkak të përmirësimit të efikasitetit të përpjekjeve për gjetjen dhe identifikimin e të ardhurave, pronës ose përfitimeve tjera pasurore që mund të jenë lëndë e masave të përkohshme për sigurim ose konfiskim. Përveç kësaj, Zyra e ARO-s ka për obligim rregullisht të mbledhë, përpunojë dhe analizojë të dhëna statistikore gjithëpërfshirëse në lidhje me masat e përkohshme për sigurim dhe konfiskim. Zyra e ARO-së përballet me mungesë të burimeve njerëzore dhe materiale-teknike që janë të nevojshme për implementimin me sukses të zgjidhjes ligjore.

2.2.2. Sigurimi dhe konfiskimi i përkohshëm i pronës dhe përfitimeve pasurore

Zbatimi i masave të përkohshme për sigurimin e pronës dhe përfitimeve pasurore nga vepra kriminale është hap vendimtar për konfiskim të suksesshëm, pasi zbatimi i tyre në kohë parandalon fshehjen, tjetërsimin, transferimin jashtë vendit në juridiksion të huaj dhe asgjësimin e pronës ose përfitimeve pasurore të identifikuara të fituara në mënyrë të paligjshme. Për këtë qëllim, prokurori publik është i detyruar gjatë procedurës të mbledhë dëshmi që janë të rëndësishme për përcaktimin e pronës dhe përfitimeve pasurore të caktuara dhe, varësisht nga dëshmitë dhe faktet e vërtetuara ligjërisht relevante, të propozojë masa për sigurimin e tyre të përkohshëm me qëllim konfiskimin.

Edhe pse prokurori publik propozon masa të përkohshme për sigurim, policia gjyqësore ka detyrë ka për detyrë që në fazë më të hershme të hetimit penal të kryejë hetim financiar dhe në varësi nga informacionet dhe dëshmitë e marra gjatë hetimit financiar gjatë zbatimit të hetimit financiar, të parashtrojë iniciativë deri prokurori publik për sigurimin e pronës dhe përfitimeve pasurore të identifikuara të fituara në mënyrë të paligjshme³⁴.


Menaxhimi me pronën e sekuestruar përkohësisht është segment i rëndësishëm nga kjo fushë prioritare, e cila ska për qëllim ruajtjen e vlerës së saj. Duke njohur rrezikun real që prona e sekuestruar përkohësisht ta humbasë vlerën e saj, vendet anëtare të BE-së e fusin institutin "shitjes paraprake" ose shitjes së mjeteve në fazën para sjelljes së aktgjyqimit për konfiskim³⁵, zbatimi i të cilit është një nga treguesit për vlerësimin e efikasitetit të sistemit të përgjithshëm të konfiskimit. Përkatesisht, pasuria që është lëndë e sigurimit së përkohshme mund ti transferohet ose shitet para vendimit përfundimtar për konfiskim nëse pasuria shpejt e humbe vlerën, shpenzimet për ruajtjen ose mirëmbajtjes e saj janë në disproporcion me vlerën e saj të tregut ose për menaxhimin e pasurisë janë të nevojshme kushte dhe njohuri profesionale që nuk janë lehtë të disponueshme.

Përveç kësaj, është e nevojshme që gjatë hetimit, prokurori publik, në koordinim me të gjitha institucionet e përfshira, të ndërmarrin masa për kontrollimin e gjendjes së pronës dhe menjëherë të ndërmirren masa për sigurimin e saj të përkohshëm. Përveç policisë gjyqësore, prokurori publik sipas nevojës, mund të konsultojë AMPS-në me qëllim të menaxhimit në kohë me pronën e sekuestruar në kohën. Faza e "Planifikimit para sekuestrimit" do të përpunuar në PSO-të për kryerjen e hetimeve financiare të PP, MPB, DD dhe DPF. Përkatesisht PP,MPB , DD, DPF, si dhe gjykatat mund ta konsultojnë me AMPS-në në fazën hetimore para sekuestrimit, gjë që do t'i mundësojë Agjencisë të jep këshillë në lidhje me veprimet që duhet të ndërmirren në lidhje me pasurinë (vlerësimi i pasurisë, vlerësimi i shpenzimeve të mundshme për menaxhimin dhe alternativat për sekuestrimin e pasurisë).

³³ Gazeta zyrtare e RMV nr. 66/2024

³⁴ Procedurat standarde operative për kryerjen e hetimeve financiare në MPB, DPF dhe DD

³⁵ Direktiva (BE) 2024/1260 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 24 prill 2024, për kthimin dhe konfiskimin e pasurisë, Neni 21, Shitja paraprake



Paraqitje grafike e vlerës së pasurisë së sekuestruar përkohësisht në vitet 2020, 2021, 2022 dhe 2023 në PThPNKOK (vlera është shprehur në euro)³⁶

Konfiskimi i pasurisë së fituar në mënyrë të paligjshme bazohet në parimin se askush nuk mund ta mbajë përfitimin e drejtpërdrejtë dhe të tërthortë pasuror të përfutur me veprën penale. Masa e lartpërmendur e së drejtës penale nënkupton respektimin e parimit ligjor se e gabuar nuk mund të bëhet e drejtë³⁷, me çka në fakt bëhet korrigjimi i të gabuarës, përkatësisht kthimi në gjendjen e mëparshme që ekzistonte para kryerjes së veprës penale.

Duke përmbushur detyrimet e ndërmarra me konventat ndërkombëtare të ratifikuara në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit⁴⁰, në legjislacionin penal janë përfshirë dispozita për konfiskimin e zgjeruar për vepra penale të numëruara në mënyrë taksative³⁸, me çka kryesit i kalon barra e provës për disproporcionin e vërtetuar të pasurisë me çka disponon me të ardhurat e tij të ligjshme. Edhe pse dispozitat për konfiskimin e zgjeruar ishin futur me reformat e së drejtës materiale penale në vitin 2009, përsëri kjo dispozitë nuk priti zbatim efikas. Me ndryshimet e Kodin Penal³⁸ në vitin 2023, u krye zgjerimi i katalogut të veprave penale për të cilat mund të kryhet konfiskimi i zgjeruar.

Prona dhe përfitimet pasurore, me rregull konfiskohen me vendim gjykate me çka vërtetohet kryerja e veprës penale, dhe vendim për konfiskim gjykata do të sjellë edhe në procedurë të posaçme dhe atëherë kur nga pengesat faktike ose ligjore, nuk është e mundur zhvillimi i procedurës penale kundër kryesit të veprës penale³⁹. Është detektuar nevoja për përpunim shtesë të procedurës së posaçme për konfiskimin e pronës ose përfitimeve pasurore pa zhvillim të procedurës penale (kur ekzistojnë pengesa faktike ose ligjore për zhvillimin e procedurës penale kundër personit që ka kryer veprën penale).

Sjellja e Direktivës 2024/1260 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të 24 prillit 2024 për kthimin dhe konfiskimin e pasurisë vlerësohet si vendimtar, hap vendimtar i BE-ja në luftën e mëtejshme me krimin e organizuar. Dispozitat e reja që u japin mjete shteteve anëtare të BE-së për monitorim efikas dhe të shpejtë, identifikim, ngrirje dhe menaxhim me pronën e konfiskuar imponojnë nevojën për analizë gjithëpërfshirëse të legjislacionit në vendin tonë që e rregullon instituti i konfiskimit dhe rrjedhimisht, nëpërmjet vlerësimit të praktikave të mira të vendeve evropiane të propozohen zgjidhje të përshtatshme ligjore.


Të dhënat statistikore për pronën e konfiskuar në vitet e fundit tregojnë se aktgjykimet e plotfuqishme penale gjyqësore përfundojnë me dënime penale, por pa konfiskim të pronës së fituar në mënyrë të paligjshme ose me pak konfiskim të suksesshëm. Nga analiza e të dhënave statistikore, mund të konkludohet se në RMV vlera e pronës për të cilën është përcaktuar masë e përkohshme për sigurim, si dhe për të cilën është shqiptuar masë konfiskimi të pronës, është më e larta në vitin 2022. Të dhënat statistikore 2019-2023 (PThPNKOK), vlera është shprehur në euro:

³⁶ Raporte vjetore për punën e PP për vitet 2023, 2022

³⁷ Kambovski, E drejta penale-pjesa e përgjithshme, Shkup 2011, faq.519

³⁸ "Gazeta Zyrtare e RMV "nr.188/2023

³⁹ LPP, neni 540



Sfidat dhe dobësitë:

I. Nevoja për përmirësimin e kornizës ligjore:

- Masat e përkohshme për sigurimin e pronës që janë rregullua në LPP dhe që përbëhen nga ndalimi i përdorimit, tjetërsimit ose disponimit, mund ta arrijnë efektin dhe ta ruajnë pronën për konfiskim të mëvonshëm vetëm nëse ato zgjasin deri në përfundimin të plotfuqishëm të procedurës. Në mbështetje është edhe rekomandimi i ekspertëve të KE-së në Raportin e Misionit të Vlerësimit për Luftën kundër Krimit të Organizuar⁴⁰, të cilët tregojnë se masa për sigurimin e pronës duhet të vendoset deri në përfundimin e plotfuqishëm të procedurës, dhe jo deri në sjelljen e vendimit të shkallës së parë, siç është zgjidhja aktuale e përfshirë në LPP.
- Praktika gjyqësore sugjeron në nevojën nga ripërpunim të dispozitës ligjore që e rregullojnë masat e përkohshme të sigurisë (neni 202 i LPP-së), veçanërisht në lidhje me elementët që duhet ti përmbajë propozimi i prokurorit publik, si dhe aktvendimi i gjykatës, me qëllim që të sigurohet përfshirja e të gjitha të dhënave relevante të nevojshme për identifikimin e qartë dhe të saktë të pronës që është lëndë e vendosjes së masës së përkohshme të sigurisë.
- Është e nevojshme që në KPP të parashikohen dispozita plotësuese për shitjen e pronës së siguruar përkohësisht në fazën para sjelljes së aktgjykimit.
- Lidhur me dispozitat që e rregullojnë konfiskimin e pasurisë, futet nevoja nga ripërpunime plotësuese të dispozitave që lidhen me konfiskimin e zgjeruar, si dhe procedurën e veçantë të konfiskimit në LPP.

II. Forcimi i kapaciteteve të Prokurorisë Publike

Duke analizuar kapacitetet e PP për kryerjen e hetimeve komplekse penale dhe financiare, ekspertët e KE-së në Raportin e misionit të vlerësimit të kryer për luftën kundër krimit të organizuar⁴¹, ndër të tjera, japin këto rekomandime:

- Të sigurohet që PP e kanë pajisjen e nevojshme, kapacitete adekuate hapësinore dhe numër të mjaftueshëm të punësuarve;
- Të sigurohet prania e ekspertëve financiarë ose analistëve në PP;
- Të përmirësohet specializimi institucional dhe individual në kuadër të PP;
- Parashikimi i hetimeve financiare si tregues për vlerësimin e punës së prokurorëve publikë.

⁴⁰ E zbatuar në RMV në periudhë prej 20 deri 24 qershor

⁴¹ Rekomandimet e ekspertëve të KE kanë të bëjnë me kapacitetet e PThPNKOK, por të njëjtat janë ndërmarrë për forcimin e kapaciteteve të PPRMV

Nevoja nga optimizimi i kuadrove në PP është konstatuar edhe në Raportin për Punën e PP për vitin 2023, në të cilin drejtohet se PP në vazhdimësi përballen me mungesë të burimeve njerëzore: numër të pamjaftueshëm të prokurorëve publikë dhe nëpunësish të prokurorisë publike, me çka është evidentuar edhe mungesë e kuadrove nga fusha e teknologjive të informacionit dhe komunikimit.

Në përputhje me Raportin Vjetor për Punën e Këshillit të Prokurorëve Publikë për vitin 2023, funksioni i prokurorit publik gjatë vitit 2023 e kanë kryer 179 prokurorë publikë ose 82 prokurorë publikë më pak se sa ishte parashikuar me vendimin për përcaktimin e numrit të prokurorëve publikë në prokuroritë publike.

Rritja e burimeve të prokurorëve publikë, si dhe nëpunësve të prokurorisë publike, veçanërisht angazhimi i ekspertëve të IT-së, ekspertëve financiarë ose analistëve, do të kontribuojë në rritjen e efikasitetit në punën, gjë që, ndër të tjera, do të rezultojë edhe me zbatimin në kohë të masave të përkohshme për sigurimin e pronës së zbuluar të fituar në mënyrë të paligjshme, si parakusht për konfiskim të suksesshëm.

III. Mungesa e statistikave të unifikuara

Mungesa e sistemit gjithëpërfshirës, të saktë dhe të besueshëm për grumbullimin, përpunimin e të dhënave për pronën e konfiskuar e pengon shqyrtimin e efektivitetit të politikave në këtë fushë, kështu që vështirë mund të përcaktohet nëse masat i kanë realizuar qëllimet e tyre dhe rezultatet e pritura. Përveç saj që rrit dukshmërinë e punës së institucioneve (policia gjyqësore, prokuroria publike, gjykatat dhe agjencia e menaxhimit të pronës së sekuestruar), ekzistenca e sistemi statistikor të besueshëm është pjesë e rëndësishme nga funksionimi i sistemit të drejtësisë penale⁴².

Direktiva 2024/1260 i përcakton të dhënat statistikore në bazë të së cilave shtetet snëtare të BE-së e rishikojnë efikasitetin e sistemeve të tyre për sekuestrimin e pasurisë.⁴³ Në RMV, hap i madh në këtë fushë është sjellja e Ligjit për Zyrën e Kthimit të Pasurisë (Zyra ARO), e cili parashikon detyrim në Zyrën e Prokurorisë Publike të RMV-së të vendoset bazë e të dhënave elektronike të integruar për nevojat e Zyrës ARO. Duke marrë parasysh të dhënat që do të përmbahen në bazën e theksuar⁴³, në korrelacion me të dhënat statistikore të cilat i fut Direktiva 2024/1260, imponohet nevoja për analiza dhe harmonizim shtesë të të dhënave statistikore mbi bazën e të cilave do të shihet efikasiteti i sistemit për sekuestrimin e pronës.

Gjithashtu, një kontribut të madh në krijimin e sistemi statistikor të besueshëm do të ketë regjistri elektronik i pasurisë së sekuestruar, i cili duhet të vendoset në AMPS⁴⁴, dhe në të cilin do të përmbahen të dhëna për pasurinë e sekuestruar përkohësisht dhe objektet e sekuestruara përkohësisht, si dhe për pasurinë e konfiskuar dhe objektet e sekuestruara.

Në kuadër të IPA 3, Programi Vjetor 2021, do të fillojë me implementim projekti: "Krijimi i sistemit elektronik për menaxhimin e të dhënave të institucioneve për zbatimin e ligjit", i cili pritet të sigurojë të dhëna të besueshme të hetimeve, ndjekjeve penale, aktgjykimeve të plotfuqishme, sekuestrimeve dhe konfiskimeve në rastet e krimit të organizuar. Projekti i theksuar, i cili do të realizohet brenda 24 muajve (shtator 2024-gusht 2026), do të sigurojë gjithashtu implementimin e mbështetjes softuerike që do të mundësojë përpunimin më të shpejtë dhe më efikas të të dhënave.

Vendosja e sistemit për konfiskimin e pronës në procedurat civile

Me sjelljen e **Ligjit për Konfiskimin e Pronës në Procedurat Civile**⁴⁵, në legjislacionin tonë është futur mekanizëm shtesë në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, i cili duhet të parandalojë dispozicionin e pronës dhe përfitimeve pasurore që nuk mund të përfitohen nga burime të ligjshme.

⁴²Iniciativa Rajonale Kundër Korrupsionit: "Zbatimi efektiv i masave për sekuestrimin e përfitimit pasuror nga veprat penale në Ballkanin Perëndimor: shqyrtimi i Metodologjisë rajonale për monitorim, prokurorëve kryesore dhe rasteve të praktikave të mira"

⁴³Ligji për Zyrën e Kthimit të Pasurisë, neni 22: të dhëna për kërkesat e pranuar dhe të dorëzuara nga dhe deri te zyrat e ARO-së, të pranuar dhe dorëzuara shkëmbime spontane të informacioneve, të pranuar dhe të dorëzuara njoftime për praktikatat më të mira, masat eshqiptuara për ndalimin e përkohshëm të dispozicionit ose konfiskimit, si dhe kërkesat e parashtruara dhe të pranuar për bashkëpunim ndërkombëtar që kanë të bëjnë me ndalimin e përkohshëm të dispozicionit ose konfiskimit.

⁴⁴Regjistri elektronik në AMPS duhet të krijohet në afat prej 1 viti nga hyrja në fuqi e Ligjit për Menaxhim me Pronën e Konfiskuar, Fitimeve Pronësore dhe Lëndëve të Sekuestruara në Procedurat Penale dhe Kundërvajtëse.

⁴⁵"Gazeta Zyrtare e RMV " np.53/2024

Kusht për fillimin e procedurës për përcaktimin e pronës, fitimi i së cilës nuk mund të tregohet se është nga burime të ligjshme është nëse: (I) ekziston dyshim i arsyeshëm se ekziston pronë, fitimi i së cilës nuk mund të tregohet se është nga burime të ligjshme dhe (II) ekziston disproporcion midis vlerës neto të pronës dhe të ardhurave të ligjshme dhe të raportuara në dispozicion për fitimin e pronës, të shprehura si diferencë kumulative që tejkalon 13,000 euro në kundërvlerë në denarë sipas kursit të mesëm të këmbimit të BPRMV-së, e llogaritur në vit në periudhë kohore jo më të gjatë se 10 vjet para fitimit të pronës që është lëndë e kësaj procedure, përkatësisht veprimet për kryerjen e veprave penale të përcaktuara konkretisht ⁴⁶ për të cilat ekziston dyshim i arsyeshëm se është i lidhur, përkatësisht është burimi i mjeteve për fitimin e pronës. ⁴⁷Ngarkesa e provës se prona është fituar nga burime të ligjshme është në anën të paditurit në procedurë.

Kur **prokurori publik** dyshon për kryerjen e veprave penale të caktuara, por nuk ka dëshmi të mjaftueshme për ndjekje penale ose ndjekja penale nuk ka çuar në aktgjykim dënues, dhe vlerësoi se ekziston dyshim i arsyeshëm se pasuria nuk është fituar nga burime të ligjshme, është i detyruar të dorëzojë iniciativë në DPF për shqyrtimin dhe mbledhjen e të dhënave për burimet dhe mënyrën se si është fituar pasuria. Prokurori publik është edhe organ kompetent për parashtrimin e iniciativës në Prokurorin e shtetit për fillimin e padisë.

Drejtoria e Policisë Financiare është organ kompetent për grumbullimin e të dhënave për pronën, përfitimi i së cilës nuk mund të tregohet se është nga burime të ligjshme. Procedurën që e zbaton DPF është urgjente.

Avokati shtetëror është organ shtetëror i autorizuar që ndërmer masa dhe mjete juridike para organeve shtetërore kompetente dhe fillon procedurat para gjykatës kompetente për të përcaktuar pronën, përfitimi i së cilës nuk mund të tregohet se është nga burime të ligjshme në procedurë civile.

Sfidat dhe dobësitë:

Në fokusin i aktiviteteve të ardhshme do të jetë ndërtimi i kapaciteteve të DPF-së si organ kompetent për grumbullimin e të dhënave dhe sigurimin e dëshmive të pronës, fitimi i së cilës nuk mund të tregohet se është nga burime të ligjshme, si dhe analizën e tyre. Për këtë qëllim, në DPF është e nevojshme të krijohet njësi e specializuar për trajtimin e lëndëve në përputhje me ligjin e lartpërmendur. Ky proces duhet të shoqërohet me krijimin e kapaciteteve institucionale (sigurimin e burime njerëzore, trajnimin e tyre, pajisjet materiale- teknike) të të gjitha subjekteve të përfshira në procedurën për konfiskimin e pronës në procedurat civile, duke përfshirë edhe Prokurorinë Publike, Avokaturën e Shtetit, gjykatat dhe AMPS-në. Zbatimi i shtyrë i dispozitave të këtij ligji e imponon nevojën për aktivitete intensive nga institucionet për të siguruar kushte për zbatimin e pa pengesë të zgjidhjes ligjore. ⁴⁸

Me sjelljen e Ligjit për Zyrën e Kthimit të Pasurive dhe Ligjit për Konfiskimin e Pronës në Procedurën Civile, implementohen rekomandimet, përkatësisht tejkalohen sfidat e identifikuara në kuadër të ciklit të dytë të shqyrtimit të implementimit të Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit, në pjesën e dispozitave nga nenit 51, nenit 53, nenit 54, fq.1, p. (a) dhe 55, fq.1, pika (b).

2.2.3.Menaxhimi me pronën e konfiskuar, duke përfshirë edhe përdorimin e sërishëm të saj për qëllime sociale

Menaxhimi me pronën e konfiskuar dhe shitja e saj e vazhdueshme, si faza e fundit e ciklit të konfiskimit të pronës së fituar në mënyrë të paligjshme, shënon përfundimin me sukses dhe rrumbullakosjen e procedurave të zhvilluara më parë para prokurorive publike, para organeve tjera dhe në gjykata. Segmenti i menaxhimit të pronës së konfiskuar, ruajtja, magazinimi dhe shitja e saj është në kompetencë të Agjencisë për Menaxhimin e Pronës së Konfiskuar, e cila është themeluar me Ligjin për Menaxhimin e Pronës së Konfiskuar, Përfitimit Pronësor dhe Lëndëve të Konfiskuara në

⁴⁶ Definuar në nenin 8 të Ligjit për Konfiskimin e Pronës në Procedurën Civile

⁴⁷ Ligji për Konfiskimin e Pronës në Procedurë Civile, neni 9

⁴⁸ Ligji për Konfiskimin e Pronës në Procedurë Civile është publikuar në Gazetën Zyrtare të RMV më 4 mars 2024 dhe do filloj të zbatohet pas përfundimit të gjashtë muajve nga data e hyrjes në fuqi.


Procedurën Penale dhe Kundërvajtëse ⁴⁹ si organ i pavarur i administratës shtetërore i cili për punën e vet i përgjigjet Qeverisë.

Në bazë të vendim të gjykatës për sekuestrimin dhe konfiskimin e pronës dhe përfitimeve pasurore, si rezultat i aktiviteteve të koordinuara të AMPS-së, në Buxhet janë transferuar shumat e mëposhtme të mjeteve (mjetet e sekuestruara dhe të konfiskuara dhe mjetet nga shitja e pronës së sekuestruar dhe të konfiskuar):

Viti 2020: 65.000.000,00 den. ose 1.063.643 euro

Viti 2021: 42.000.000 ,00 den.ose 682.927 euro

Viti 2022 : 396.978.383,00 den. ose 6.984.903,00 euro



Shqyrtim grafik e mjeteve të sekuestruara dhe të konfiskuara dhe mjeteve nga shitja e pronës së sekuestruar dhe të konfiskuar të transferuara në Buxhetin e RMV-së 2020-2022, vlera është shprehur në euro



Shqyrtim grafik i mjeteve nga shitjet të transferuara në Buxhetin e RMV-së në periudhën 2019-2022

Shumat e lartpërmendura të pronës së sekuestruar dhe të konfiskuar janë pjesërisht për shkak të kuadrit ligjor në ligjet procedurale, por mangësi u gjetën edhe në zgjidhjen e vjetër ligjore, implementimi i së cilës në praktikë tregoi një numër dobësish. Sjellja e Ligjit të ri për Menaxhimin e Pronës së Konfiskuar, Përfitimeve Pronësore dhe Lëndëve të Sekuestruara në Procedurat Penale dhe Kundërvajtjeje, në të cilin përfshihen standardet ndërkombëtare për trajtimin e pronës së konfiskuar⁵⁰, duhet të sigurojë që procedurat për menaxhimin e pronës së konfiskuar të zbatohen shpejt dhe me efikasitet,

⁴⁹ "Gazeta Zyrtare e RM nr..98/08 и 145/10, sjellë në gusht të vitit 2008 , ndërsa filloi të zbatohet prej 1 janar 2009

⁵⁰ Direktiva 2014/42/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit Evropian prej 3 prill 2014 për ngrirjen dhe konfiskimin e sendeve dhe të ardhurave nga veprat penale në Bashkimin Evropian.

gjë që do të rezultojë në shitjen e shpejtë të pronës së sekuestruar dhe të konfiskuar dhe me këtë edhe hyrje të drejtpërdrejtë në Buxhet.

Ligji i lartpërmendur e rregullon edhe shitjen e lëndëve të sekuestruara dhe pronën e konfiskuar jashtë vendit, duke i dhënë autorizim Drejtorit të AMPS-së të nënshkruajë marrëveshje për bashkëpunim të ndërsjellë me institucionet kompetente për menaxhimin e pronës së sekuestruar jashtë vendit⁵¹. Sigurimi i implementimit të qëndrueshëm të zgjidhjeve të reja ligjore është sfidë që institucionet duhet ta arrijnë në periudhën e ardhshme përmes realizimit të masave konkrete.

Analiza dhe praktika ekzistuese tregojnë se për AMPS është e nevojshme të marrë rregullisht mjete financiare në rritje për të kryer me sukses dhe në kohë përgjegjësitë e saj. Ligji i ri krijon parakushte ligjore për realizimin e qëllimit të theksuar duke paraparë mundësinë që AMPS të mbajë 7% nga vlera e të ardhurave të realizuara nga çdo shitje e sendeve të sekuestruara dhe pronës së konfiskuar nga Agjencia dhe 100% të mjeteve nga qiraja që do të përdoren për organizimin e vazhdueshëm të aktiviteteve të saj. Ligji i lartpërmendur gjithashtu parashih edhe mundësinë që 2% e vlerës së të ardhurave të realizuara nga çdo shitje e lëndëve të sekuestruara dhe pronës së konfiskuar nga Buxheti i RMV-së ti transferohen PPRMV, MPB, DPF dhe DD

Agjencia përballat edhe me kapacitete të pamjaftueshme njerëzore dhe hapësinore për të mundësuar menaxhimin efikas të pronës së sekuestruar, akomodimin dhe ruajtjen e përshtatshme të pronës së sekuestruar, të cilat janë parakushte të nevojshme për ruajtjen e vlerës së pronës së sekuestruar, por edhe për kryerjen me sukses të procedurës për shitjen dhe ripërdorimin social të pronës së sekuestruar dhe të konfiskuar.

Përdorimi i pronës së sekuestruar dhe të konfiskuar për qëllime sociale

Përdorimi i pronës së sekuestruar dhe të konfiskuar për qëllime sociale është mjet për dërgimin e sinjalit të fortë se konfiskimi nuk është vetëm instrument për sekuestrimin e pronës dhe përfitimeve pasurore nga krimi i organizuar për shkak të mbushjes së buxheteve të pushtetit publik, por ajo ka edhe mekanizëm të dobishëm dhe transparent nga ana sociale, që i bën pronën e konfiskuar drejtpërdrejt ose tërthorazi të disponueshme për qytetarët. Pastaj, këto praktika e bëjnë drejtësinë më të dukshme, e rivendosin besimin e qytetarëve tanë në gjyqësor dhe ndihmojnë në rifitimin e besimit në sistemin gjyqësor⁵².

Ligji për Menaxhimin e Pasurisë së Konfiskuar, Përfitimit Pasuror dhe Sendeve të Sekuestruara në Procedurë Penale dhe Kundërvajtëse⁵³ parashikon detyrimin e Agjencisë për të publikuar sendet e sekuestruara dhe pasurinë e konfiskuar përmes regjistrit elektronik, ku organet shtetërore, fondet, agjencitë, institucionet publike dhe ndërmarrjet publike, trupat rregullatore të pavarura të themeluara nga shteti, njësitë e vetëqeverisjes lokale, si dhe shoqatat dhe fondacionet kanë mundësinë të paraqesin nevojat e tyre tek Agjencia duke bashkangjitur një elaborat për qëllimin dhe realizimin e qëllimeve me arsyetim social. Kjo mundësi ligjore, e cila do të zhvillohet më tej me akt nënligjor, hap derën për zbatimin e mekanizmave efektivë për disponimin e pasurisë së konfiskuar.

2.3. Analiza e mjedisit (Analiza SWOT dhe PESTLE)

Analiza SWOT

Anët e forta

Anët e dobëta

⁵¹ Ligji për Menaxhimin e Pasurisë së Konfiskuar, Përfitimeve Pasurore dhe Sendeve të Sekuestruara në Procedurë Penale dhe Kundërvajtjeje, Neni 52

⁵² Direktiva 2014/42/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të Bashkimit Evropian për ngrirjen dhe konfiskimin e sendeve dhe të ardhurave nga veprat penale në Bashkimin Evropian.

⁵³ Ligji për Menaxhimin e Pasurisë së Konfiskuar, Përfitimit Pasuror dhe Sendeve të Sekuestruara në Procedurë Penale dhe Kundërvajtëse, neni 54.

- Arritje e nivelit më të mirë në kryerjen e hetimeve financiare dhe e pasurisë së konfiskuar - Sigurimi i përfshirjes së të gjitha institucioneve shtetërore - Forcimi i bashkëpunimit me agjencitë e BE-së dhe trupat ndërkombëtare	- Kuadër i pamjaftueshëm i institucioneve - Burime financiare të kufizuara për realizimin e qëllimeve të përcaktuara - Mosrespektimi i detyrimeve ligjore dhe afateve të përcaktuara
Kërcënimet	Mundësitë
Ndryshimi i prioriteteve strategjike	Kontribut në përmbushjen e qëllimeve të procesit të eurointegrit
Pasojat ekonomike nga ndodhitë në nivel global	Rritje e besimit nga qytetarët

Tabela. Analiza SWOT.

ANALIZA PESTLE:

Faktorë politik	Faktorë ekonomik	Faktorë social	Faktorë teknologjikë	Faktorë juridikë	Faktorë ekologjikë
Klimë e qëndrueshme politike	Mjete financiare të disponueshme nga buxhetet e institucioneve	Informimi i publikut	Digjitalizimi i institucioneve, përfshirë edhe trajnimin e të punësuarve	Korniza ekzistuese ligjore (akte ligjore dhe nënligjore)	Ndryshimet klimatike dhe rrethanat e shkaktuara nga faktorë natyrorë dhe njerëzorë
Prioritete strategjike të Qeverisë	Mjete financiare nga organizatat ndërkombëtare për realizimin e projekteve	Përfshirja e shoqërisë civile	Disponueshmëria e pajisjeve bashkëkohore teknologjike	Harmonizimi i legjislacionit nacional me të drejtën e BE-së	
Obligime që rrjedhin nga procesi i eurointegrit	Kriza globale			Raporte dhe rekomandime ndërkombëtare	

3. KORNIZA STRATEGJIKE

3.1. Duke pasur parasysh analizën e gjendjes, si dhe sfidat dhe mangësitë e konstatuara, me Strategjinë 2025–2028 përcaktohet si vijon:

VIZIONI
Sistem efikas për konfiskimin e pasurisë dhe përfitimit pasuror, me rezultate të dukshme dhe të matshme në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, përmes kapaciteteve të ndërtuara për gjetjen, identifikimin dhe ndjekjen e pasurisë së fituar në mënyrë të paligjshme brenda dhe jashtë vendit, sigurimin e saj me kohë, sekuestrimin dhe menaxhimin e saj.

3.2. Për realizimin e këtij vizioni janë përcaktuar këto qëllime të përgjithshme dhe të veçanta:

Fusha prioritare 1: GJETJA, IDENTIFIKIMI DHE NDJEKJA E PASURISË SË FITUAR NË MËNYRË TË PALIGJSHME NË VEND DHE JASHTË VENDIT

QËLLIMI I PËRGJITHSHËM 1: Funksionalitet i përmirësuar i institucioneve për gjetjen, identifikimin dhe ndjekjen e pasurisë së fituar në mënyrë të paligjshme brenda dhe jashtë vendit

QËLLIMI I VEÇANTË 1.1: Institucionet zhvillojnë hetime financiare në përputhje me standardet e BE-së

QËLLIMI I VEÇANTË 1.2: Zyra për Kthimin e Pasurisë (Zyra ARO) është plotësisht operative dhe funksionale

Fusha prioritare 2: SIGURIM I PÛRKOHSHËM DHE KONFISKIM I PASURISË DHE PÛRFITIMIT PASUROR
--

QËLLIMI I PËRGJITHSHËM 2: Forcimi i kapaciteteve dhe efikasitetit të institucioneve kyçe kompetente për sigurimin e përkohshëm dhe konfiskimin e pasurisë dhe përfitimit pasuror

QËLLIMI I VEÇANTË 2.1: Përmirësimi i zbatimit të masave të përkohshme për sigurimin dhe konfiskimin

QËLLIMI I VEÇANTË 2.2: Krijimi i një sistemi funksional për konfiskimin e pasurisë në procedurë civile

Fusha prioritare 3: MENAXHIMI I PASURISË SË SEKUESTRUAR DHE TË KONFISKUAR, PÛRFSHIRË DHE PÛR PÛRDORIMIN E TIJ TË SËRISHËM PÛR QËLLIME SOCIALE

QËLLIMI I PËRGJITHSHËM 3: Ruajtja dhe mirëmbajtja e vlerës së pasurisë së përkohshëm të sekuestruar dhe të konfiskuar

QËLLIMI I VEÇANTË 3.1: Forcimi i kapaciteteve dhe efikasitet më i madh i Agjencisë për Menaxhimin e Pasurisë së Sekuestruar

QËLLIMI I VEÇANTË 3.2: Përmirësimi i mekanizmit për përdorimin e pasurisë së sekuestruar dhe të konfiskuar për qëllime sociale

Fusha prioritare 4: Zbatimi i Strategjisë dhe monitorimi i aktiviteteve të përcaktuara në (PV)
--

3.3. MASAT PÛR REALIZIMIN E QËLLIMEVE TË PËRGJITHSHME DHE TË VEÇANTA:

Fusha prioritare 1: Gjetja, identifikimi dhe ndjekja e pasurisë së fituar në mënyrë të paligjshme brenda dhe jashtë vendit

Qëllimi i përgjithshëm do të realizohet përmes zbatimit të qëllimeve të veçanta në vijim:

Qëllimi i veçantë 1.1: Institucionet zhvillojnë hetime financiare në përputhje me standardet e BE-së

M1: Përmirësimi i kornizës ligjore për kryerjen e hetimeve financiare dhe trajnimi i të punësuarve në institucionet për zbatimin e saj efikas

Korniza ligjore aktuale nuk përmban dispozita eksplicite për kryerjen e hetimeve financiare. Me **Ligjin e ri për Procedurën Penale** pritet të definohen qëllimet e hetimit financiar, kur zhvillohen, roli udhëheqës i prokurorit publik gjatë zhvillimit të hetimit financiar, detyrimi i policisë gjyqësore, sipas detyrës zyrtare apo sipas urdhrit të prokurorit publik, për të zhvilluar hetime financiare për gjetjen e përfitimeve të drejtpërdrejta dhe të tërthorta nga veprat penale, të cilat mund të jenë lëndë e sigurimit të përkohshëm për konfiskim, si dhe për gjetjen e pasurisë që mund të jetë lëndë e konfiskimit të zgjeruar.

Në kuadër të kësaj mase, do të miratohet **Ligji i ri për Drejtorinë Doganore**, në të cilin do të inkorporohen dispozita për qasjen e DD-së në një numër më të madh regjistrash të të dhënash nga institucione të tjera, që do të mundësojnë qasje më të shpejtë dhe më të lehtë në informacion dhe të dhëna për kryerjen e hetimeve financiare.

Për shkak të mungesës së harmonizimit të Ligjit për Punë Devizore me Ligjin për Drejtorinë e Doganës dhe, si pasojë, rekomandimit të marrë nr. 32 të Raportit të RMV-së nga Komiteti MONEYVAL, do të ndryshohet **Ligji për Punë Devizore** në drejtim të harmonizimit me Ligjin për Drejtorinë e Doganës. Në mënyrë plotësuese, do të miratohen edhe akte nënligjore për zbatimin e pandërprerë të ligjit.

Drejtoria e Policisë Financiare do të forcojë kornizën ligjore për kryerjen e hetimeve dhe konfiskimin e pasurisë në mënyrë më sistematike dhe funksionale me miratimin e **Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Policinë Financiare**. Ndryshimet e përmendura ligjore do të përmirësojnë gjithashtu procedurën e punësimit dhe selektimit për fillimin e marrëdhënies së punës në DPF-së, si dhe të drejtat dhe detyrimet e policëve financiarë.

Duke pasur parasysh rolin kyç të të dhënave bankare në kryerjen e hetimeve financiare, **Ligji për bankat**⁵⁴ me të cilin do të mundësohet në bazë të kërkesës së shkruar nga MPB-ja për zhvillimin e procedurave në kuadër të kompetencave të saj, qasje në dokumente, të dhëna dhe informacione mbi aktivitetet dhe transaksionet bankare dhe të tjera financiare për persona veç e veç⁵⁵.

Do të miratohet **Procedurë Operative Standarde për kryerjen e hetimeve financiare në Prokurorinë Publike**, pas së cilës do të vijoj trajnimi i prokurorëve publik dhe policisë gjyqësore në qendrat hetimore.

Miratimi i Ligjit për Procedurën Penale, si dhe POS për kryerjen e hetimeve financiare në PP-në, do të krijojë nevojën për **rishikimin e POS për kryerjen e hetimeve financiare në MPB, DD dhe DPF**.

M2: Përf forcimi i kapaciteteve të qendrave ekzistuese hetimore dhe krijimi i qendrave të reja hetimore për rritjen e efikasitetit të hetimeve dhe përmirësimin e koordinimit Edhe pse në periudhën e kaluar janë arritur rezultate në lidhje me pajisjen me staf të qendrave hetimore, është e nevojshme një forcim i mëtejshëm kadrovik me hetues në qendrat hetimore, trajnimi i tyre, si dhe pajisja hapësinore dhe teknike e qendrave hetimore. Sigurimi i digjitalizimit të qendrave hetimore ka rëndësi thelbësore për kryerjen e hetimeve financiare efektive. Formimi i qendrave të reja hetimore, sipas nevojave, do të përmirësojë koordinimin e prokurorëve publikë me MPB, DD dhe DPF.

M3: Përmirësimi i funksionalitetit të njësive për kryerjen e hetimeve financiare në MPB, DPF dhe DD.

⁵⁴ "Gazeta Zyrtare e RM-së" nr. 67/07, 90/09, 67/10, 26/13, 15/15, 153/15, 190/16 dhe 7/19 dhe "Gazeta Zyrtare e RMV-së" nr. 101/19, 122/21.

⁵⁵ Sipas nenit 122 të Ligjit për Bankat, bazuar në kërkesë me shkrim, DD dhe DPF kanë qasje në të dhënat e përmendura.

Vlerësimi i Strategjisë 2021–2023 theksoi nevojën për forcimin e kapaciteteve kadrovike dhe materiale-teknike të njësive të specializuara për kryerjen e hetimeve financiare në MPB, DD dhe DPF.

Duke pasur parasysh se pajisja teknike e njësive të përmendura është një proces shumëvjeçar, do të ndërmerret sigurimi gradual i pajisjeve të nevojshme. Është e domosdoshme të përgatitet një analizë e pajisjeve teknike të nevojshme, në përputhje me kërkesat dhe trendet bashkëkohore për kryerjen e hetimeve financiare.

Procesi i përmendur do të koordinohet nga Komisioni Nacional dhe do të përfshijë njësitë e specializuara për kryerjen e hetimeve financiare në MPB (përfshirë njësitë organizative në sektorët për punë të brendshme përgjegjëse për krimin ekonomik), DPF (përfshirë sektorët e tjerë në kuadër të Drejtorisë) dhe DD.

Në bazë të analizës së realizuar do të hartohet një Plan për forcimin teknik të njësive për kryerjen e hetimeve financiare, i cili do të inkorporohet në planet vjetore operative për zbatimin e strategjisë në fjalë.

Një segment thelbësor, nga i cili varet si pajisja kadrovike ashtu edhe ajo teknike e njësive të specializuara të përmendura, është sigurimi i kapaciteteve hapësinore dhe pajisja e tyre në MPB, DPF dhe DD.

M4: Formimi i ekipeve të përziera për kryerjen e hetimeve financiare nën drejtimin e prokurorit publik.

Për hetime financiare komplekse dhe të gjera, për të cilat kërkohet një qasje ndërdisiplinore, do të formohen ekipe të përziera me përfaqësues nga MPB, UFPN dhe CU, të cilat do të krijohen për një rast konkret dhe do të jenë nën drejtimin e prokurorit publik.

Ekipet e përmendura do të formohen pas një vlerësimi paraprak nga prokurori publik për nevojën e veprimit të përbashkët, duke pasur parasysh llojin e veprës penale, njohuritë profesionale dhe mundësitë teknike me të cilat disponojnë institucionet e përmendura.

M5. Vendosja e sistemit të integruar të trajnimeve

Aftësia për zbatimin me sukses të hetimeve financiare nënkupton kompetencë të lartë profesionale dhe aftësi për gjetjen, përpunimin dhe analizimin e një numri të madh të dhënash dhe informacionesh financiare dhe të tjera.

Për këtë qëllim, Qendra për Trajnim në MPB do të hartojë një Program mësimor për nivelin bazë për trajnim në kryerjen e hetimeve financiare dhe një Program mësimor për nivelin e avancuar për kryerjen e hetimeve financiare.

Programet e përmendura të trajnimit do të jenë të dedikuara për punonjësit në njësitë e specializuara për kryerjen e hetimeve financiare në MPB, UFPN dhe CU, si dhe për hetuesit në qendrat hetimore.

Sigurimi i një sistemi konsistent të trajnimeve të përbashkëta, të strukturuar në një program të përbashkët mësimor, do të kontribuojë në forcimin paralel të kapaciteteve të tyre, por edhe të besimit të ndërsjellë.

Trajnimi bazë do të sigurojë zbatim të qëndrueshëm të SOP-eve për kryerjen e hetimeve financiare, si dhe të dispozitave të legjislacionit penal.

Trajnimet e specializuara do të hartohen në përputhje me nevojat e institucioneve, por edhe me trendet bashkëkohore të veprimit të grupeve të krimit të organizuar.

Zbatimi i trajnimeve multidisiplinare për kryerjen e hetimeve financiare (punë praktike me raste, trajnim në kontabilitet, pasqyrat e pozicionit financiar dhe pasqyrat e të ardhurave, aftësi për përcaktimin e vlerës së pasurisë me origjinë të paligjshme përmes llogaritjes sipas metodës së vlerës neto, përpunim dhe analizë analitike të të dhënave financiare) do të sigurojë koordinim më të mirë dhe bashkëpunim ndërsektorial.

Është e nevojshme të vendoset edhe një vlerësim pasues i trajnimeve të realizuara, me qëllim përcaktimin e ndikimit të tyre.

M6: Përmirësimi i shkëmbimit elektronik të të dhënave dhe dokumenteve me institucionet që përmbajnë të dhëna relevante për kryerjen e hetimeve financiare.

Është imperativ të mundësohet qasje sa më e shpejtë dhe më e gjerë në bazat e të dhënave të institucioneve të tjera që janë të domosdoshme për kryerjen e hetimeve financiare, duke pasur parasysh se aktualisht qasja në to është e kufizuar.

Për këtë qëllim, do të ndërmerren hapa për lidhjen e marrëveshjeve për interoperabilitet dhe për sigurimin e operacionalizimit të tyre.

Procesi i përmendur do të shoqërohet me trajnim të punonjësve të policisë gjyqësore për përdorimin e platformës së interoperabilitetit.

M7: Intensifikimi i bashkëpunimit me agjencitë e BE-së.

E nevojshme është përfshirja ndërkombëtare në luftën kundër krimit të organizuar, si dhe ndërmarrja e hapave të mëtejshëm për zhvillimin e partneriteteve dhe bashkëpunimit me vendet e BE-së.

Duke pasur parasysh se 65% e grupeve kriminale të organizuara aktive në BE përbëhen nga anëtarë të nacionaliteteve të ndryshme që veprojnë në nivel transnacional, intensifikimi i bashkëpunimit me agjencitë e BE-së (Europol, Cepol dhe Eurojust), si dhe me rrjetin OLAF (KARIN, Grupi Egmond etj.) është i rëndësishëm kyç.

Me themelimin e Qendrës Evropiane për Krim Financiar dhe Ekonomik, Europol ka rritur kapacitetet e veta për të mbështetur vendet anëtare në kryerjen e hetimeve financiare. Forcimi i bashkëpunimit me Europol, duke përfshirë shkëmbimin e përvojave dhe praktikave të mira, do të kontribuojë në zbatimin më efektiv të standardeve të BE-së në kryerjen e hetimeve financiare.

Do të vazhdohet me pjesëmarrje aktive në aktivitetet operative të EMPACT, ku hetimet financiare janë një komponent i rëndësishëm.

Qëllimi i veçantë 1.2: Zyra për Kthim e Pasurisë (Zyra ARO) është plotësisht operacionale dhe funksionale

Krijimi i Zyrës funksionale për Kthimin e Pasurisë është prioritet në këtë fushë, i cili do të sigurohet përmes masave të mëposhtme:

M1: Përmbyllja e kornizës ligjore.

Direktiva e Parlamentit Evropian dhe Këshillit 2019/1153 për përcaktimin e rregullave për lehtësimin e përdorimit të informacionit financiar dhe të tjera për parandalimin, zbuluar dhe hetimin e disa veprave penale, si dhe Direktiva 2024/1260 për kthimin dhe konfiskimin e pasurisë, imponojnë detyrimin që zyrat ARO të kenë qasje të drejtpërdrejtë në regjistrin e llogarive bankare. Në këtë drejtim, do të ndryshohet **Ligji për Shërbimet dhe Sistemet e Pagesave**, me të cilin do t'i mundësohet Zyrës për Kthimin e Pasurisë qasja në regjistrin unik të llogarive.

Miratimi i Ligjit për Zyrën për Kthimin e Pasurisë, si dhe procedurat operative standarde për kryerjen e hetimeve financiare në Prokurorinë Publike, imponojnë nevojën për **rishikimin e procedurave ekzistuese operative standarde** të Zyrës për Kthimin e Pasurisë.⁵⁶

Miratimi i Direktivës 2024/1260 për kthimin dhe konfiskimin e pasurisë sjell kompetenca të reja dhe të fuqizuara për zyrat ARO. Me qëllim të unifikimit të kompetencave të Zyrës ARO në RMV me zyrat përkatëse në vendet anëtare të BE-së, do të kryhet një analizë e dispozitave të Direktivës 2024/1260 dhe, në përputhje me rezultatet, do të vendoset për ndryshime të mundshme në Ligjin për Zyrën për Kthimin e Pasurisë.

M2: Sigurimi i burimeve njerëzore dhe materiale-teknike

Zyra ARO duhet të sigurohet me burime të përshtatshme që do t'i mundësojnë të ushtrojë në mënyrë efektive rolin e saj si pikë qendrore nacionale, ku do të mblidhen kërkesat nga vendet e tjera. Duke pasur parasysh se në këtë moment Zyra

⁵⁶ Rregulloret operative standarde (SOP) të Zyrës për Kthimin e Pasurisë janë miratuar në 30 dhjetor 2020

ARO nuk disponon staf të mjaftueshëm profesional, ICT dhe administrativ-teknik të nevojshëm për zbatimin e suksesshëm të kompetencave ligjore, është e domosdoshme forcim i stafit me burime njerëzore të kualifikuara.

Niveli profesional i punonjësve do të mbahet dhe forcohet përmes trajnimeve fillestare, të vazhdueshme dhe të specializuara. Njëkohësisht, do të ndërmerret fuqizim institucional duke siguruar kapacitete hapësinore të pajisura në mënyrë të përshtatshme për realizimin e kompetencave.

M3: Sigurimi i koordinimit ndërresorial

Multisektorialiteti i strukturës së Zyrës ARO do të sigurohet përmes caktimit të personave kontaktues nga institucionet shtetërore relevante. Konkretisht, organet vendore të drejtësisë, organet vendore që marrin pjesë në hetimin financiar dhe institucionet e tjera vendore, me kërkesë të Zyrës ARO, do të caktojnë një person kontakti me Zyrën ARO.

Në këtë mënyrë do të krijohet një rrjet personash kontaktues nga organet dhe institucionet relevante, të cilët do të jenë të obliguar të veprojnë në kohë dhe në mënyrë të plotë sipas kërkesave të dërguara nga Zyra ARO. Pas caktimit të personave kontaktues, do të realizohet trajnim për ta lidhur me dispozitat e Ligjit për Zyrën për Kthimin e Pasurisë.

Koordinimi ndërinstitutional do të forcohet gjithashtu përmes bashkëpunimit intensiv të Zyrës ARO me AMPS-në në drejtim të identifikimit të pasurisë dhe ruajtjes së vlerës së saj.

M4: Krijimi i bazës së të dhënave elektronike të integruar për nevojat e Zyrës ARO

Në Prokurorinë Publike të RMV-së do të krijohet bazë e integruar elektronike e të dhënave, në të cilën të dhënat do t'i fusin Zyra ARO, organet vendore të drejtësisë dhe organet vendore që marrin pjesë në hetimin financiar, ndërsa atyre do t'u mundësohet qasje përkatëse në varësi të kompetencave të tyre të përcaktuara me ligj.

Përveç kërkesave të pranura dhe të dërguara nga dhe drejt zyrave ARO, në bazën e përmendur do të përfshihen edhe të dhëna për masat e shqiptuara të ndalimit të përkohshëm të disponimit dhe të konfiskimit, duke mundësuar shqyrtimin, analizën dhe monitorimin e tyre.

Duke pasur parasysh kompleksitetin e këtij procesi, do të miratohet një akt nënligjor me të cilin do të rregullohet mënyra e futjes dhe qasjes në të dhënat në këtë bazë, si dhe procedurat teknike të sigurisë gjatë mbledhjes, përpunimit dhe ruajtjes së të dhënave.

Është e domosdoshme të sigurohet staf IT që do të jetë përgjegjës për mirëmbajtjen e saj. I gjithë procesi do të përmbyllet me trajnim të punonjësve të Zyrës ARO dhe të institucioneve të tjera që do të kenë kompetencë për futjen dhe përdorimin e të dhënave.

M5: Sigurimi i qasjes në bazat e tjera të të dhënave në vend

Qasja në bazat e të dhënave është një segment veçanërisht i rëndësishëm për zbatimin efektiv dhe në kohë të rolit të Zyrës ARO. Duhet të sigurohet qasje në të gjitha bazat relevante të të dhënave që mund të jenë të dobishme për identifikimin dhe gjetjen e pasurisë dhe përfitimit pasuror si produkte të veprës penale.

Pas analizës së kryer, sipas një dinamike të përcaktuar, Zyra ARO do të fillojë me nënshkrimin e marrëveshjeve për shkëmbim elektronik të të dhënave me institucionet përkatëse dhe do të sigurojë operacionalizimin e tyre.

Me qëllim që të sigurohet respektimi i rregullave të konfidencialitetit të të dhënave të marra, do të realizohet trajnim i stafit të Zyrës ARO për mbrojtjen e të dhënave personale.

M6: Shkëmbimi i informacionit me Zyrat ARO në shtetet e tjera

Për të siguruar sigurinë e informacionit që shkëmbehet me Zyrat ARO të shteteve të tjera, Zyra ARO do të përdorë aplikacionin e sigurisë SIENA, i menaxhuar nga Europol. Për këtë qëllim do të sigurohet qasje e drejtpërdrejtë e Zyrës ARO në kanalin e sigurisë SIENA, përmes nënshkrimit të një Protokolli për bashkëpunim midis MPB-së dhe Zyrës ARO. Në të njëjtën kohë, do të zhvillohet trajnim për stafin e Zyrës ARO për përdorimin e këtij kanali të sigurt për komunikim.

Përveç kësaj, do të sigurohet përfshirja e Zyrës ARO në rrjetet ndërkombëtare të lidhura me gjetjen, identifikimin, ngrirjen dhe konfiskimin e pasurisë së fituar në mënyrë të paligjshme.

M7: Përfshirja e Zyrës ARO në rrjetet ndërkombëtare të lidhura me gjetjen, identifikimin, ngrirjen dhe konfiskimin e pasurisë (CARIN, ARINs, GFAR, GFPIN, ARNUK, EUROJUST, UNODC, KE) përmes pjesëmarrjes në konferenca, shkëmbimit të përvojave dhe praktikave të mira.

M8: Sigurimi i transparencës

Me qëllim arritjen e një transparence më të madhe në punën e saj, parashikohet ekzistimi i një faqeje funksionale të internetit, në të cilën do të publikohen rregullisht raportet vjetore të Zyrës ARO dhe njoftime të tjera të rëndësishme, me qëllim informimin e publikut profesional dhe të gjerë për punën e Zyrës ARO.

FUSHA PRIORITARE 2: SIGURIMI I PÛRKOHSHËM DHE KONFISKIMI I PASURISË DHE PÛRFITIMIT PASUROR

Qëllimi i përgjithshëm do të realizohet përmes zbatimit të qëllimeve të mëposhtëm të veçantë:

Qëllimi i veçantë 2.1. Përmirësimi i zbatimit të masave të përkohshme për sigurimin dhe konfiskimin e pasurisë dhe përfitimit pasuror si rezultat i veprës penale

M.1. Përmirësimi i kornizës juridike në lidhje me sigurimin e përkohshëm dhe konfiskimin e pasurisë dhe përfitimit pasuror si rezultat i veprës penale

Në kuadër të kësaj mase do të sillet **Ligji i ri për Procedurën Penale**, me të cilin do të adresohen mangësitë e konstatuara në lidhje me masat e përkohshme të sigurimit dhe konfiskimin e pasurisë dhe përfitimit pasuror.

Duke ndjekur udhëzimet e Direktivës 2024/1260, me **Ligjin e ri për Bashkëpunim Ndërkombëtar në Çështjet Penale** do të rregullohet më tej ekzekutimi i ndërsjellë i konfiskimit të pasurisë dhe përfitimit pasuror jashtë vendit, si dhe menaxhimi i pasurisë së siguruar përkohësisht jashtë vendit.

Do të kryhet analizë gjithëpërfshirëse e legjislacionit në vendin tonë që rregullon institutin e konfiskimit nga aspekti i përputhshmërisë me **Direktivën 2024/1260 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, të datës 24 prill 2024, për rikuperimin e pasurisë dhe konfiskimin** dhe, si rrjedhojë, përmes shqyrtimit të praktikave më të mira të shteteve evropiane, do të propozohen zgjidhje përkatëse ligjore.

M2: Forcimi i kapaciteteve të PP për kryerjen e hetimeve komplekse kriminale dhe financiare, në përputhje me rekomandimet e Raportit të misionit vlerësues për luftën kundër krimit të organizuar.

M3: Krijimi i sistemit elektronik për mbajtjen e evidencës nga institucionet për zbatimin e ligjit, me mbështetje nga Programi IPA 3 2021.

M4: Trajnime të ndër-institucionale të specializuara për kryerjen e hetimeve financiare, sigurimin e përkohshëm, konfiskimin dhe menaxhimin e pasurisë së sekuestruar dhe të konfiskuar (Policia Gjyqësore, gjykatës, prokurorë, AMPS). Trajnimet do të jenë të fokusuar në sigurimin e zbatimit të saktë të dispozitave të Ligjit të Kodit Penal në lidhje me masat e përkohshme për sigurimin dhe konfiskimin, si dhe të dispozitave të Ligjit për menaxhimin e pasurisë së konfiskuar, dobive të konfiskuara pronësore dhe sendeve të sekuestruara në procedura penale dhe për kundërvajtje. Objekt i trajnimit do të jenë edhe aktgjykimet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Qëllim i veçantë 2.2:

Krijimi i sistemit funksional për konfiskimin e pasurisë në procedurë civile

Наведената посебна цел ќе се реализира преку следните мерки:

M1. Përmbyllja e kornizës ligjore

Kuadri ligjor do të përfundohet me miratimin e Udhëzimeve për veprimtarinë e prokurorëve në procedurën e konfiskimit në procesin civil, të cilat do të zhvillojnë më tej dispozitat e Ligjit për konfiskimin në procedurë civile dhe do të unifikojnë mënyrën e veprimit të prokurorëve.

M2. Krijimi i njësisë së specializuar në Drejtorinë e Policisë Financiare

Duke pasur parasysh se procedura e konfiskimit në procesin civil është urgjente dhe Drejtoria e Policisë Financiare është e obliguar ta kryejë procedurën e kontrollit dhe llogaritjeve financiare brenda një afati jo më të madh se 60 ditë, është jashtëzakonisht e rëndësishme që në kohë të shkurtër të krijohet dhe të sigurohet funksionaliteti i plotë i njësisë së specializuar në Drejtorinë e Policisë Financiare. Për këtë qëllim, do të ndryshohet Akti për sistematizimin e vendeve të punës në Drejtorinë e Policisë Financiare, me të cilin do të krijohet njësia e specializuar përgjegjëse për trajtimin e rasteve të konfiskimit në procedurë civile, dhe do të ndërmerren masa për sigurimin e kuadrove cilësorë, trajnimin e tyre për dispozitat e ligjit, si dhe pajisjen hapësinore dhe materiale-teknike të njësisë së përmendur.

M4: Zbatimi i trajnimit për të gjithë subjektet e përfshira në procedurën e konfiskimit të pasurisë në procesin civil (PP, DPF, ASH, MPB, DAP, DD, AKP, KShPK, gjykatat)

Duke pasur parasysh rolin kyç të PP, DPF ASH dhe gjykatave në procedurën e konfiskimit në procedurën civile, është e domosdoshme të organizohet trajnim për punonjësit e këtyre institucioneve për zbatimin e saktë të dispozitave të ligjit. Në trajnim duhet të përfshihen edhe punonjësit e Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, organeve tatimore, Drejtorisë së Ardhurave Publike, Agjencisë së Kadastrës së Paluajtshmërive, Drejtorisë së Doganave dhe organeve e institucioneve të tjera që janë të obliguara, nëse brenda kompetencave të tyre marrin informacione ose të dhëna nga të cilat lind dyshimi ose njohuri për ekzistencën e pasurisë për të cilën nuk mund të provohet se është fituar nga burime ligjore, të njoftojnë menjëherë DPF.

Fusha prioritare 3: MENAXHIMI I PASURISË SË SEKUESTRUAR DHE TË KONFISKUAR, PËRFSHIRË EDHE PËRDORIMIN E SAJ TË SËRISHËM PËR QËLLIME SOCIALE

Qëllimi i përgjithshëm do të realizohet përmes qëllimeve të veçanta të mëposhtme:

Qëllimi i veçantë 3.1: Përforcimi i kapaciteteve dhe rritja e efikasitetit të Agjencisë së Menaxhimit me Pasuri të Sekuestruar

Efikasiteti i sistemit për sekuestrimin e pasurisë dhe menaxhimin e saj është domosdoshmërisht i lidhur me kapacitetet e AMPS-së, profesionalizmin, kompetencën dhe regullshmërinë e punonjësve të saj. Përforcimi i saj si institucion shtetëror përgjegjës dhe llogaridhënës, i cili vepron sipas parimeve të ligjshmërisë, ekonomisë, efikasitetit dhe me kujdes si nikoqir i mirë, do të mbështetet nga masat e mëposhtme, të cilat në thelb synojnë të sigurojnë implementim efektiv të zgjidhjes së re ligjore:

M1: Avancimi i kornizës ligjore

Ligji i ri për Menaxhimin e Pasurisë së Konfiskuar, Përfitimeve Pasurore dhe Sendeve të Sekuestruara në Procedurë Penale dhe për Kundërvajtje ka vendosur nevojën për sjelljen e akteve nënligjore, me të cilat do të zhvillohen më tej disa aspekte të rëndësishme. Përveç rregulloreve që do të rregullojnë disa aspekte profesionale të punës së AMPS-së, do të sillen edhe Rregullorja për sistematizimin e vendeve të punës dhe Rregullorja për organizimin e brendshëm të AMPS-së. Korniza ligjore do të kompletohet me rishikimin e përmbajtjes së Kodeksit të punonjësve të AMPS-së dhe pas kësaj do të realizohet trajnimi i punonjësve.

M2: Përforcimi i kapaciteteve kadrovike dhe pajisja teknike e Agjencisë së Menaxhimit me Pasuri të Sekuestruar

Me rëndësi të veçantë është forcimi i burimeve njerëzore të AMPS-së me profile të ndryshme punonjësish, të cilët janë të domosdoshëm për ushtrimin efikas të kompetencave të AMPS-së (punonjës në sektorë të veçantë: juristë, ekonomistë, kuadër i IT-së dhe personel ndihmës-teknik). Përzgjedhja e kuadrove gjatë punësimit në Agjenci duhet të bazohet në profesionalizëm dhe kompetencë, duke marrë parasysh përvojën dhe njohuritë. Është e nevojshme të sigurohet proces i vazhdueshëm i zhvillimit profesional të punonjësve të AMPS-së, i cili do të kontribuojë në rritjen e nivelit të profesionalizimit të tyre.

Gjithashtu, janë të nevojshme burime materiale për pajisjen teknike të AMPS-së, veçanërisht për sigurimin dhe pajisjen e hapësirave të zyrave, si dhe të pajisjeve informatike. Ushtrimi i suksesshëm i kompetencës parësore të AMPS-së imponon nevojën për pajisje shtesë teknike për ruajtjen, evidencën dhe mirëmbajtjen e pasurisë, si dhe për burime teknike për magazinim dhe veprimtari depozitimi të AMPS-së.

M3: Krijimi dhe mirëmbajtja e regjistrit elektronik për pasurinë e sekuestruar

Për pasurinë e sekuestruar përkohësisht dhe sendet e sekuestruara përkohësisht, si dhe për pasurinë e konfiskuar dhe sendet e marra, është e nevojshme që AMPS-ja të krijojë regjistrë elektronik në të cilin do të evidentohen organi dhe baza ligjore e sekuestrimit ose konfiskimit, vlera e vlerësuar, vendi dhe mënyra e ruajtjes, përshkrimi i pasurisë, si dhe mënyra e amenaxhimit dhe disponimit të saj. Paralelisht me krijimin e zgjidhjes softuerike për evidencën e pasurisë së sekuestruar, Bordi drejtues i Agjencisë, me akt nënligjor, do të rregullojë përmbajtjen, mënyrën e mbajtjes, qasjen dhe përdorimin e të dhënave nga regjistri elektronik. Gjithashtu, do të realizohet trajnim i punonjësve për përdorimin e regjistrit elektronik.

M4: Sigurimi i qasjes në bazat e të dhënave të institucioneve të tjera

AMPS do të lidhet elektronikisht me sistemin informatik të Agjencisë së Kadastrës së Patundshmërive, Regjistrin Qendror, Depozitarin Qendror të Letrave me Vlerë dhe Byrosë Kreditore dhe do t'i përdorë shërbimet e tyre në mënyrë elektronike. Gjatë shkëmbimit të dokumenteve dhe të dhënave elektronike, AMPS do të përdorë Platformën nacionale për interoperabilitet. Për këtë qëllim, AMPS do të lidhë memorandume bashkëpunimi me Agjencinë e Kadastrës së Patundshmërive, Regjistrin Qendror, Depozitarin Qendror të Letrave me Vlerë dhe Byronë Kreditore, në të cilat do të rregullohet mënyra e shkëmbimit të të dhënave. Gjithashtu, AMPS do të bashkëpunojë dhe do të kryejë shkëmbim të dhënash me organe dhe institucione të tjera shtetërore që mbajnë regjistra zyrtarë lidhur me pasurinë e konfiskuar. Paralelisht me lidhjen e marrëveshjeve për qasje në bazat e të dhënave të institucioneve të tjera dhe sigurimin e operacionalizimit të tyre në praktikë, do të realizohet trajnim i punonjësve të AUOI-së për përdorimin e platformës së interoperabilitetit.

M5: Përmirësimi i kapaciteteve hapësinore për ruajtjen/magazinimin e pasurisë së sekuestruar

Duke qenë se një nga kompetencat themelore të AMPS-së është ruajtja, magazinimi dhe menaxhimi i pasurisë së sekuestruar, është e domosdoshme të sigurohen kapacitete të përshtatshme hapësinore për ruajtjen e pasurisë së sekuestruar, në përputhje me standardet e BE-së. Procesi në fjalë do të zbatohet në mënyrë të planifikuar dhe etapë pas etape: mbi bazën e analizës funksionale të gjendjes dhe nevojave të realizuar, do të silllet Plan për përmirësimin e kapaciteteve hapësinore për ruajtjen e pasurisë së sekuestruar dhe të konfiskuar, në përputhje me standardet e BE-së.

Me qëllim ruajtjen e vlerës fillestare të sendeve në momentin e sekuestrimit dhe sigurimin e kushteve adekuate për magazinimin e disa sendeve specifike, do të sigurohet ruajtja e tyre adekuate përmes lidhjes së kontratave me palë të treta.

M6: Përmirësimi i koordinimit ndërresor

Me qëllim përmirësimin e koordinimit dhe bashkëpunimit, do të formohet grup punues ndërresor nga ekspertë për sekuestrimin dhe menaxhimin e pasurisë, i përbërë nga përfaqësues të institucioneve të ndryshme (policia gjyqësore, prokurori publik, gjykatësi, MD, Zyra për Kthimin e Pasurisë, përfaqësues i AMPS-së). Përmes mbajtjes së takimeve të rregullta koordinuese tremujore, ky grup punues do të kontribuojë në përmirësimin e kuptimit nga të gjitha palët e

përfshira mbi sfidat ligjore, logjistike dhe të tjera që hasen në praktikë, si dhe do të veprojë si forum për nismën dhe zgjidhjen e çështjeve që lindin nga rastet individuale.

Për më tepër, koordinimi ndërresorjal do të përmirësohet edhe përmes lidhjes së protokolleve/marrëveshjeve nga AMPS-ja me institucionet e tjera.

M7: Intensifikimi i bashkëpunimit ndërkombëtar

AMPS është anëtare e Rrjetit Ballkanik Inter-agjencish për Menaxhimin e Pasurisë së Paligjshme (BAMIN), i cili përbëhet nga agjenci për menaxhimin e pasurisë së sekuestruar dhe të konfiskuar nga 23 vende, pjesëmarrës si anëtarë ose vëzhgues. Në periudhën prill 2024 – prill 2025, AUOI do të kryesojë rrjetin BAMIN, ku Kuvendi i përgjithshëm vjetor i rrjetit do të mbahet në RMV.

Duke pasur parasysh detyrimin ligjor të AMPS-së për të lehtësuar procedurën e menaxhimit dhe shitjes së sendeve të sekuestruara dhe të pasurisë së konfiskuar jashtë vendit, për secilin rast veç e veç, drejtori i AMPS-së do të lidhë marrëveshje bashkëpunimi me institucionet kompetente për menaxhimin e pasurisë së sekuestruar dhe të konfiskuar në vendet e huaja. Këto aktivitete janë në përputhje me Direktivën 2024/1260, e cila përcakton bashkëpunimin me autoritetet e tjera përgjegjëse për menaxhimin e pasurisë së sekuestruar dhe të konfiskuar në çështjet ndërkufitare si një nga detyrat kryesore të agjencive për menaxhimin e pasurisë së sekuestruar dhe të konfiskuar.⁵⁷

M8: Sigurimi i transparencës më të madhe të punës së AMPS-së

Krijimi i regjistrit elektronik do të kontribuojë në sigurimin e rritjes së transparencës. Sigurimi i qasjes në regjistrin elektronik për të gjitha palët e interesuara do t'u mundësojë atyre të kenë informacion të plotë mbi vendndodhjen dhe vlerën e mjeteve që menaxhon AMPS, si dhe mbi kostot e tyre të mirëmbajtjes.

Është e nevojshme informimi i rregullt i publikut për aktivitetet brenda kompetencës së AMPS-së. Për këtë qëllim, duhet të përditësohet rregullisht faqja e ueb-it të AMPS-së, duke përfshirë publikimin e rregullt të raporteve vjetore të punës së AMPS-së.

Qëllim i veçantë 3.2: Përmirësimi i mekanizmit për përdorimin e pasurisë së sekuestruar dhe të konfiskuar për nevoja sociale

Qëllimi i veçantë i përmendur do të realizohet përmes masave në vijim:

M1: Sjellja e akteve juridike për përmirësimin e mekanizmit të përdorimit social të pasurisë së sekuestruar dhe të konfiskuar

Edhe pse Ligji i Menaxhimit të Pasurisë së Konfiskuar, Përfitimeve Pasurore dhe Sendeve të Sekuestruara në Procedurë Penale dhe të Kundërvajtjes përmban dispozita që rregullojnë këtë mekanizëm, është e nevojshme të miratohen aktet nënligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kushtet, mënyrën e vendimmarrjes për shpërndarjen dhe prioritetet për dhënien e sendeve të sekuestruara dhe të pasurisë së konfiskuar.

M2: Ngritja e vetëdijes për rëndësinë dhe ndikimin e këtij mekanizmi mbi nevojat sociale të qytetarëve, që do të realizohet përmes organizimit të trajnimeve dhe seminareve, hulumtimeve mbi prioritetet shoqërore dhe analizës së praktikave të mira evropiane për përdorimin social të pasurisë së konfiskuar, duke përfshirë sektorin civil dhe institucionet e tjera relevante.

Transparenca e procedurave për përdorim social të pasurisë së sekuestruar dhe të konfiskuar do të sigurohet përmes krijimit dhe mirëmbajtjes së regjistrit elektronik.

⁵⁷ Direktivata 2024/1260 na Evropскиот Парламент и на Советот од 24 Април 2024 за поврат на имот и конфискација, член 22

Fusha prioritare 4: ZBATIMI I STRATEGJISË DHE MONITORIMI I AKTIVITETEVE TË PËRCAKTUARA NË PLANIN E VEPRIMIT

Qëllimi i lartpërmendur do të realizohet përmes masave në vijim:

M1: Përforsimi i monitorimit dhe ndjekjes së zbatimit të Strategjisë, i cili do të realizohet përmes miratimit të Vendimit për formimin e Këshillit Nacional për kryerjen e hetimeve financiare dhe konfiskimin e pasurisë. Këshilli në fjalë do të miratojë Rregulloren e punës dhe do të mbajë takime të rregullta në nivel tremujor.

M2: Përforsimi i kapaciteteve të Komisionit Nacional për Kryerjen e Hetimeve Financiare dhe Konfiskimin e Pasurisë, përmes miratimit të Rregullores së punës së Komisionit Nacional, krijimit të evidencës elektronike të të dhënave dhe miratimit të Metodologjisë për monitorimin e Strategjisë dhe mbledhjen e të dhënave. Hartimi i planeve operative vjetore, raporteve vjetore për progresin në zbatimin e Planit të Veprimit (PV) dhe dorëzimi i tyre pranë Këshillit janë pjesë e masave që do të kontribuojnë në ndjekjen më efikase të masave të përcaktuara në PV. Nën udhëheqjen e Komisionit Nacional do të hartohet Plani për pajisje materiale-teknike të institucioneve që zhvillojnë hetime financiare (MPB, DD, DPF), si dhe do të koordinohet procesi i hartimit të analizës së modelit për krijimin e një fondi/llogarie të veçantë në të cilin do të transferoheshin mjetet financiare që rrjedhin nga sekuestrimi dhe konfiskimi i pasurisë, ose një pjesë e tyre. Komisioni Nacional, në mbledhjet e tij, do të shqyrtojë edhe programet vjetore të trajnimit për trajnim fillestar dhe të specializuar dhe, nëse konstatohet mungesë e mjeteve financiare, do t'i paraqesë ato pranë Këshillit. Me mbështetje nga donatorët, Komisioni Nacional do të zhvillojë trajnime të vazhdueshme për anëtarët e Komisionit Nacional lidhur me aktet e reja juridike të BE-së dhe praktikën më të mira të vendeve anëtare të BE-së në fushën e zhvillimit të hetimeve financiare dhe konfiskimit të pasurisë.

IV. KORNIZË PËR MONITORIMIN, VLERËSIMIN DHE NJOFTIMIN

4.1. Paraqitje tabelare e treguesve të suksesit në nivel rezultati, përfundimi dhe efekti – kornizë e treguesve ndërlidhur me fushat prioritare, qëllimet e përgjithshme dhe të veçanta, së bashku me vlerën fillestare, vlerën kalimtare dhe vlerën përfundimtare të secilit nga treguesit e përcaktuar – në shtojcë.

4.2. Organet kompetente përgjegjëse për zbatimin, monitorimin, vlerësimin dhe njoftimin dhe organet që marrin pjesë në procesin e monitorimit, vlerësimit dhe njoftimit

Korniza institucionale për zbatimin, monitorimin, vlerësimin dhe njoftimin:

- I. **Këshilli Nacional për Hetime Financiare dhe Konfiskimin e Pasurisë**, në nivel politik, siguron monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit të Strategjisë dhe Planit të veprimit.
- II. **Komisioni Nacional për Hetime Financiare dhe Konfiskimin e Pasurisë**, në nivel profesional dhe teknik, koordinon zbatimin e aktiviteteve të përcaktuara në Strategji dhe Planin e veprimit (PV). Komisioni Nacional ka rolin e trupit koordinues për monitorim dhe njoftim pranë Këshillit Nacional për Hetime Financiare dhe Konfiskimin e Pasurisë.
- III. **Njësia organizative në Qeverinë e RMV-së / Kabineti i zëvendëskryetarit të Qeverisë së RMV-së i angazhuar për Politikën e Qeverisjes së Mirë**, e cila siguron mbështetje profesionale dhe teknike për mbledhjet e Komisionit Nacional dhe të Këshillit.
- IV. **Institucionet e përcaktuara në Planin e veprimit (PV)** janë përgjegjëse për zbatimin e masave brenda afateve kohore të përcaktuara në PV.

4.3. Mënyra e mbledhjes së të dhënave

Zbatimin e masave dhe aktiviteteve konkrete do ta kryejë institucioni i caktuar në Planin e veprimit (PV), në përputhje me kornizën kohore për zbatimin e tyre të përcaktuar në PV.

Komisioni Nacional mbledh informacione për realizimin e PV-së përmes takimeve të rregullta dhe raporteve zyrtare mbi shkallën e realizimit të masave dhe aktiviteteve në fushat përkatëse prioritare.

Komisioni Nacional do të sjellë Metodologji për monitorimin e strategjisë, si dhe mjetet për ndjekjen dhe mbledhjen e të dhënave.

4.4. Mekanizëm për koordinim

4.4.1 Këshilli Nacional për Hetime Financiare dhe Konfiskimin e Pasurisë (në tekstin e mëtejshëm: Këshilli) përbëhet nga anëtarët në vijim: zëvendëskryetari i Qeverisë së RMV-së, i angazhuar për Politikën e Qeverisjes së Mirë, ministri i Punëve të Brendshme, ministri i Drejtësisë, ministri i Financave, Prokurori publik i RMV-së, Kryetari i Gjykatës së Lartë të RMV-së, udhëheqësi i ARO-së, drejtori i Byrosë së Sigurisë Publike në MPB, drejtori i Drejtorisë Doganore, drejtori i Drejtorisë së Policisë Financiare, drejtori i Agjencisë së Menaxhimit me Pasuri të Sekuestruar dhe të Konfiskuar dhe Kryetari i Komisionit Nacional për Hetime Financiare dhe Konfiskimin e Pasurisë. Me Këshillin kryeson zëvendëskryetari i Qeverisë, i angazhuar për Politikën e Qeverisjes së Mirë, në cilësinë e kryetarit të Këshillit. Sipas nevojës, në mbledhjet e Këshillit, varësisht nga çështjet që janë objekt shqyrtimi, mund të marrin pjesë edhe përfaqësues të institucioneve të tjera shtetërore, me propozim të Këshillit.

Këshilli mbledhet në seanca të paktën katër herë në vit, në të cilat shqyrton raportin e Komisionit Nacional për zbatimin e Strategjisë dhe Planit të veprimit (PV). Nëse vërehet ngecje në zbatimin e konkluzave të Këshillit, kryetari i Këshillit, me iniciativën e tij ose me kërkesë të anëtarit të Këshillit, mund të thërrasë edhe seancë të jashtëzakonshme.

Fushëveprimi i punës së Këshillit është monitorimi dhe vlerësimi i zbatimit të Strategjisë dhe PV-së. Në bazë të raporteve të dorëzuara nga Komisioni Nacional, Këshilli sjell konkluzë mbi shkallën e realizimit të masave dhe aktiviteteve të përcaktuara në PV, jep udhëzime për realizimin e masave të veçanta që përballen me vonesa në zbatimin e tyre, ndërmerr masa për eliminimin e rreziqeve ose vështirësive gjatë zbatimit të masave dhe aktiviteteve të planifikuara, si dhe propozon masa dhe aktivitete deri te Qeveria për zbatim efektiv dhe rritje të efikasitetit në lidhje me kryerjen e hetimeve financiare dhe konfiskimin e pasurisë. Këshilli i dorëzon Qeverisë së RMV-së Raportin vjetor për zbatimin e Strategjisë dhe PV-së.

Këshilli siguron mbështetjen e nevojshme politike për zbatimin e Strategjisë, ndjek punën e Komisionit Nacional dhe jep udhëzime për përditësimin e Planit të veprimit në përputhje me prioritetet nacionale.

Mënyra e punës së Këshillit do të rregullohet me Rregulloren, e cila duhet të sillet brenda afatit prej 3 muajsh nga formimi i tij.

4.4.2. Komisioni Nacional për Hetime Financiare dhe Konfiskim të Pasurisë, në nivel teknik dhe profesional, koordinon aktivitetet për zbatimin e masave të përcaktuara në strategji dhe Planin e veprimit (PV), siguron zbatimin konsekuent të strategjisë dhe PV-së, shqyrton efektet e zbatimit të aktiviteteve të përcaktuara dhe dorëzon raporte te Këshilli, mbledh dhe përpunon të dhëna për zbatimin e aktiviteteve të përcaktuara në strategji dhe PV, kryen analizë të problemeve të identifikuara gjatë realizimit të aktiviteteve dhe propozon zgjidhje te Këshilli, inicon dhe rekomandon ndërmarrjen e masave në rast të rreziqeve të konstatuara nga moszbatimi ose vështirësive në realizimin e qëllimeve të përcaktuara në PV, dorëzon raporte të rregullta tremujore dhe vjetore te Këshilli dhe përgatit propozimstrategji për hetime financiare dhe konfiskim të pasurisë si dhe PV. Komisioni Nacional monitoron zbatimin e zgjidhjes ligjore të përcaktuar me Ligjin për Menaxhimin e Pasurisë së Konfiskuar, Përfitimeve Pasurore dhe Sendeve të Sekuestruara në Procedurë Penale dhe Kundërvajtëse, i cili përcakton mundësi prej 2% nga vlera e të ardhurave të realizuara nga çdo shitje e sendeve të sekuestruara dhe pasurisë së konfiskuar nga Buxheti i RMV-së të transferohen te PPRMV, MPB, DPF dhe DD për forcimin e kapaciteteve të tyre për kryerjen e hetimeve financiare, si dhe 7% te AMPS.

Komisionin Nacional e udhëheq Kryetari i Komisionit, ndërsa në të marrin pjesë përfaqësues nga institucionet që janë të përfshira në zbatimin e aktiviteteve të përcaktuara në PV. Në punën e Komisionit Nacional, sipas nevojës, mund të përfshihen ose të konsultohen përfaqësues nga institucione të tjera si dhe ekspertë të jashtëm nga fusha adekuate.

Kryetari i Komisionit Nacional e udhëheq dhe përfaqëson Komisionin Nacional; ai koordinon procesin e përgatitjes së strategjive nacionale për hetime financiare dhe konfiskim të pasurive me planet adekuate të veprimit; koordinon dhe drejton aktivitetet e të gjithë subjekteve të përfshira në zbatimin e planeve që rrjedhin nga strategjitë nacionale; ndjek trendet në nivel rajonal dhe global dhe realizon komunikim me institucionet adekuate dhe partnerët ndërkombëtarë në nivel rajonal dhe ndërkombëtar; koordinon procesin e përgatitjes së vlerësimeve, analizave dhe kërkimeve, organizimin e seminareve etj.

Për Kryetar të Komisionit Nacional është e nevojshme të emërohet person që ka përvojë shumëvjeçare në fushat e rregulluara nga strategjia dhe Planit i veprimit. Anëtar dhe zëvendësanëtar i Komisionit Nacional mund të jetë person që ka përvojë profesionale të paktën 5 vjet. Anëtarët dhe zëvendësit e tyre nga policia gjyqësore dhe organet gjyqësore duhet të kenë përvojë në kryerjen e hetimeve financiare, në propozimin dhe caktimin e masave të përkohshme për sigurim ose të masës së konfiskimit të pasurisë dhe të përfitimeve pasurore.

Komisioni Nacional mban **regjistër elektronik** për zbatimin e masave dhe aktiviteteve të përcaktuara.

Komisioni Nacional sjell Rregullore për punën e tij.

Komisioni Nacional përgatit **plane operative vjetore për zbatimin e Planit të veprimit**, jo më vonë se fundi i dhjetorit, për masat dhe aktivitetet që do të realizohen gjatë vitit pasardhës. Planet operative vjetore miratohen nga Këshilli.

4.5. Procedura dhe dinamika e njoftimit dhe vlerësimit të rezultateve të arritura

Për të siguruar monitorim të vazhdueshëm dhe sistematik të Strategjisë 2025–2028 dhe Planit të veprimit, Komisioni Nacional përgatit **raporte të rregullta periodike në bazë tremujore** të cilat i dorëzon deri te Këshilli. Këto raporte shqyrtohen në mbledhjet e Këshillit, mbi bazën e të cilave Këshilli merr konkluzione adekuate.

Komisioni Nacional përgatit gjithashtu edhe **Raport vjetor** mbi zbatimin e Planit të veprimit të strategjisë dhe arritjen e qëllimeve të përgjithshme dhe të veçanta të strategjisë për vitin paraprak, të cilin e dorëzon te Këshilli. Ky raport përgatitet në përputhje me masat dhe aktivitetet e përcaktuara në planet operative vjetore.

Raporti vjetor dorëzohet te Sekretariati i Përgjithshëm i Qeverisë së RMV-së, jo më vonë se fundi i shkurtit të vitit pasardhës dhe, pasi harmonizohet me mendimin e tij, dorëzohet te Qeveria e RMV-së jo më vonë se fundi i marsit, me kërkesë për shqyrtim dhe miratim të tij. Raportet vjetore, pas miratimit nga Qeveria e RMV-së, publikohen në faqen e internetit të Qeverisë, duke siguruar kështu transparencë mbi masat dhe aktivitetet e realizuara.

Vlerësimi i strategjisë dhe Planit të Veprimit do të kryhet pas përfundimit të periudhës së zbatimit të Planit të veprimit 2024–2026. Përveç vlerësimit të brendshëm, mund të kryhet edhe vlerësim i jashtëm. Bazuar në rekomandimet e vlerësuesve, dokumenti mund të rishikohet për të përmirësuar relativitetin, efikasitetin dhe qëndrueshmërinë e masave dhe aktiviteteve, duke u orientuar drejt arritjes së qëllimeve të përgjithshme dhe të veçanta (në korrelacion me pikën 5.3).

Vlerësimi i strategjisë dhe Planit të veprimit do të kryhet gjithashtu pas përfundimit të kornizës kohore për zbatimin e tyre, për të vlerësuar arritjen e qëllimeve të përgjithshme dhe të veçanta, si dhe qëndrueshmërinë e politikave.

V. MENAXHIMI ME RREZIQET

5.1. Rreziqe të përcaktuara që mund të ndikojnë në zbatimin dhe arritjen e qëllimeve të përgjithshme dhe të veçanta të planifikuara:

5.1.1. Përkushtim i pamjaftueshëm politik për arritjen e qëllimeve të përcaktuara;

5.1.2. Mosrespektimi i rekomandimeve nga institucionet e interesuara të dhëna nga Këshilli dhe Komisioni Nacional;

5.1.3. Mungesë e mjeteve financiare për arritjen e qëllimeve të përcaktuara;

5.1.4. Mungesë e burimeve njerëzore të kualifikuara për zbatimin e qëllimeve të përcaktuara;

5.1.5. Shkelja e afateve për arritjen e qëllimeve të përcaktuara.

5.2. Masa për përballimin e rreziqeve:

5.2.1. Rritja e numrit të takimeve konsultative në nivel nacional, dorëzimi i raporteve të rregullta në Qeverinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut me propozime për masa për tejkalimin e problemeve të konstatuara në zbatimin e masave;

5.2.2. Përforcimi i komunikimit midis Këshillit dhe Komisionit Nacional me institucionet përkatëse, monitorim më intensiv i zbatimit të rekomandimeve, si dhe siguri i përgjegjësisë politike dhe asaj administrative;

5.2.3. Sinkronizimi i planeve operative vjetore me planet buxhetore të institucioneve, siguri në kohë i mjeteve financiare, dhe siguri i mbështetjes donatore;

5.2.4. Ndërtimi i qasjes strategjike për plotësimin e kuadrit në institucionet e interesuara, përmes përforcimit të kriterëve të zgjedhjes dhe zbatimit të vazhdueshëm të trajnimeve të specializuara për zhvillim profesional dhe përmirësim të aftësive, si dhe hartimi i politikave për motivimin dhe mbajtjen e kuadrit.

5.2.5. Monitorim i përforcuar i zbatimit të masave të përcaktuara, rritje e komunikimit të ndërsjellë dhe shkëmbimi i informacionit, informim në kohë të Këshillit për vështirësitë në zbatimin e masave, e me atë edhe me rreziqet nga moszbatimi i të njëjtave.

5.3. Mënyra e rishikimit të Planit të veprimit

Nevoja për rishikimin e Planit të veprimit (PV) mund të rrjedhë nga monitorimi i zbatimit dhe analiza që kryejnë Komisioni Nacional dhe Këshilli. Bazë për këtë janë raportet tremujore dhe vjetore mbi nivelin e zbatimit të masave të përcaktuara në Planin e veprimit.

Nëse gjatë procesit të monitorimit konstatohet devijim i ndjeshëm nga dinamika e përcaktuar e zbatimit të masave dhe nga rezultatet e pritshme, ose nëse ndodhin ndryshime të rëndësishme të rrethanave dhe kushteve si pasojë e ngjarjeve, kushteve apo zhvillimeve të paparashikueshme dhe të jashtëzakonshme, do të ndërmerret rishikimi i Planit të veprimit. Po ashtu, rezultatet e vlerësimit afatmesëm të kryer nga ekspertë të pavarur mund të kontribuojnë në marrjen e vendimit për rishikimin e Planit të veprimit.

Nëse konstatohet nevoja për rishikimin e Planit të veprimit, Komisioni Nacional do të përgatitë draft të rishikuar të Planit të veprimit, të cilin do ta dorëzojë deri te Këshilli, i cili pasi ta shqyrtojë Planin e veprimit të rishikuar dhe do të japë pëlqim për masat dhe aktivitetet e rishikuara, do ta dorëzojë deri te Qeveria me propozim për miratimin e tij.

VI. PLANI INDIKATIV FINANCIAR

Mjetet financiare për zbatimin e aktiviteteve të përcaktuara në Planin e veprimit për zbatimin e Strategjisë 2024–2026 do të sigurohen nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Për disa aktivitete të përcaktuara në Planin e veprimit, natyra e të cilave e lejon këtë, mjetet financiare do të sigurohen edhe përmes mbështetjes donatore, si plotësim i mjeteve shtetërore.